Paraqitja është një element tjetër i rëndësishëm. Të siguroheni që të shfaqni një pamje profesionale, (një kompani ka shumë gjasa të punësojë dikë që paraqitet mirë); Jep dorën në mënyrë të vendosur, vështro në mënyrë të qetë e të qartë pa ngulitur sytë; Përpiqu të jesh në kohë, madje 15 minuta përpara intervistës; Jepi vetes kohë për t'u përgatitur, që të mos jeni në ankth. Nëse nuk mund të evitosh të qenit me vonesë njofto kompaninë menjëherë, duke shpjeguar arsyen dhe duke dhënë me përafërsi kohën e mbërritjes tuaj.

Në klasë janë ushtruar praktika të ndryshme se si të bëhët një intervistë pune. Ku çdo student ka marrë iniciativën të demostroj aplikimin për një vend vakant pranë një komisioni i cili edhe ky ishte i përbërë nga një grup studentësh, me rotacion.

Gjatë këtij procesi ushtrimor studentët kanë fituar aftësi për të konkuruar për një vend vakant, pasi shumë prej tyre nuk kishin qënë pjesë e intervistave për punë më parë.

MSC. Marjeta Përlala

MODULI: “MANAXHIM BIZNESI”

Leksioni nr. 5: “Komunikimi në biznes”

Në leksionin 5 “Komunikimi në biznes”, do të trajotohet rëndësia e komunikimit dhe efektevitetit në rendimentin përgjithshëm të organizatës, biznesit.

Pavarësisht se sa profesionistë të mirë jeni në kontabilitet, financë, IT, informatikë shumica e kompanive apo institucioneve presin prej jush të jeni të aftë të kryeni me sukses një sërë detyrash të lidhur me komunikimin.

- Organizimi i ideve dhe informacionit në mënyrë logjike dhe të plotë.
- Shprehja dhe prezantimi i ideve dhe informacionit në mënyrë bindëse dhe koherente.
- Të dëgjuarit e të tjerëve në mënyrë efektive.
- Komunikimi efektiv me njerëz të profileve dhe prejardhjeve të ndryshme.
- Përdorimi efektiv dhe eficent i teknologjive të komunikimit.
- Respektimi i standarteve të pranuara të gramatikës, drejtshkrimit dhe aspekteve të tjera të të shkruarit dhe të folurit.
- Komunikimi në mënyrë të civilizuar, duke respektuar etikën bashkëkohore të biznesit.

Karakteristikat e komunikimit efektiv. Ofrimi i informacionit praktik; Dhënia e fakteve, jo përshtypjeve; Qartësimi dhe përqëndrimi i informacionit; Identifikimi i saktë i përgjegjësive; Bindja e të tjerëve dhe dhënia e rekomandimeve.

Shkëmbimi i informacionit me individë brenda organizatës quhet komunikim i brendshëm, ndërsa shkëmbimi i informacionit dhe ideve me të tjerë jashtë organizatës përkufizohet si komunikim i jashtëm.

Çdo organizatë karakterizohet nga një rrjet komunikimi formal, në të cilin idetë e informacionit qarkullojnë sipas linjave hierarkike të komandimit.

Brenda rrjetit të brendshëm formal, informacioni qarkullon në tre drejtime:

1. Nga lart-poshtë (nga drejtuesit ekzekutiv tek punonjësit operativ, në formën e urdhrave, vendimeve, poro-

sive etj.);

2. Nga poshtë-lartë (nga punonjësit operativ tek drejtuesit, në formën e raporteve mbi realizimet ose mos realizimet, problemet që ndeshen etj.)
3. Horizontal (ndërmjet punonjësve apo departamenteve, drejtorive të të njëjtit nivel, me qëllim koordinimin e vepimeve për zgjidhjen e problemeve).

Çdo oragnizatë mund të identifikojë dhe rrjetin informal të komunikimit (grapevine). Ky rrjet ndërtohet në bazë të kontakteve shoqërore dhe interesave të përbashkëta kulturore, profesionale etj.

Procesi i komunikimit

1. Dërguesi ka një ide dhe dëshiron t'a komunikojë atë dikujt.
2. Dërguesi e kodon idenë, duke zgjedhur fjalët, simbolet, stilin që i mendon si të përshtatshme.
3. Dërguesi e transmeton mesazhin nëpërmjet një kanali komunikimi (e-mail, telefon, letër etj.).
4. Mesazhi arrin tek marrësi nëse nuk ndesh barrier gjatë rrugës.
5. Marrësi e dekodon mesazhin (përpiqet të kuptoj idenë e dërguesi).
6. Marrësi dërgon feedback (përgjigjja).

Pse komunikimi në biznes është unik? Organizatat sot operojnë në një mjedis dinamik dhe kompleks, kjo sjell dhe diversitet të fuqisë punëtore, që një kompani të jetë e suksesshme duhet të kuptoj se: Sa më e diversifikuar të jetë fuqia punëtore aq më shumë vëmëndje i duhet kushtuar komunikimit; Fuqia punëtore e diversifikuar mund të jetë një avantazh konkurrues (më shumë ide dhe këndvështrime të ndryshme); Vlera në rritje e informacionit të biznesit ("Punonjësit e dijes", informacione me vlerë ka të bëj me konkurrencën, nevojat e klientëve, rregulloret apo procedurat etj.); Depërtimi i teknologjive bashkohore në shkëmbimin e informacionit.

MSC. Marjeta Përlala

MODULI: “MANAXHIM BIZNESI”

Leksioni nr. 6: “Manaxhimi i punonjësve, procesi i rekrutimit”

Në leksionin 6 “Manaxhimi i punonjësve, procesi i rekrutimit”, do të shohim se sa i rëndësishëm është procesi i rekrutimit të punonjësve në një kompani.

Qëllimi dhe rëndësia e rekrutimit

- Rekrutimi është procesi ku ndërmarrja / organizata tenton të tërheq një numër kandidatësh, me të cilët ajo do të mund të plotësoj vendet bosh.
- Qëllimi kryesor i rekrutimit është sigurimi i një numri të madh kandidatësh të kualifikuar organizatës;
- Të ndikoj në rritjen e kandidatëve të kualifikuar;
- Të ndihmoj rritjen e treguesit të suksesit të procesit të seleksionimit, duke ndikuar në pakësimin e numrit të aplikantëve me kualifikim të vogël apo më të madh se sa duhet;
- Të koordinoj përpjekjet e rekrutimit me programet e seleksionimit dhe formimit;
- Të vlerësoj efektivitetin e teknikave dhe të burimeve të ndryshme të rekrutimit për të gjithë llojet e aplikantëve;
- Të plotësoj përgjegjësinë e organizatës lidhur me përbërjen e forcës punëtore.

Burimet e brendshme përfshijnë punonjësit aktualë të organizatës, të cilët bëhen kandidatë të mundshëm për promivim dhe transferime. Përparësi është sepse kemi dokumentacionin për secilin punëtor dhe këta janë familjarizuar me kushtet e punës, e njohin teknologjinë dhe procesin e punës dhe shpenzimet e rekrutimit janë më të vogla. Këtu kemi promovim që është një avancim në një pozitë me përgjegjësi më të madhe që është njëkohësisht një motivim për punëtorin. Pastaj transferimi apo rotacioni prej një vendi të punës në një tjetër me qëllim të gjetjes së një vendi më adekuat, si dhe shërben për zgjerimin e eksperiencës së

punonjësve në punë. Ky rekrutim mund të bëhet përmes shpalljes, propozimit të menaxherëve si dhe të sektorit të RH dhe inventarit të zotësive.

Orientimi për burime te jashtme zakonisht bëhet me qëllim të futjes së ideve të reja dhe kualifikimeve të reja. Kjo realizohet përmes konkurseve në gazeta, mediave, agjencive për punësim. Rekrutimi më i mirë ekziston përmes sistemit të shkollimit dmth përmes institucioneve arsimore, të larta, të shkollave të ndryshme profesionale ose instituteve të caktuara.

Konkursi – shpalljet. Nëpërmjet konkursit dhe shpalljes organizata u drejtohet njerëzve që t'i motivojë ata për të marrë pjesë në konkurs. Porosia duhet të jetë e qartë, të jetë informative (p.sh. detyrat e vendit të punës, kualifikimi minimal, mosha, gjinia), të prezentohet organizata, në mënyrë që ai merr pjesë në konkurs të ketë pasqyrën e mjaftueshme lidhur me organizatën dhe vnedin e punës për të cilëin është shpallur konkursi. Pra konkursi ka dy funksione themelore: të tërheqjes së kandidatëve dhe informative.

Seleksionimi dhe sistematizimi i punonjësve. Pasi përfundon rekrutimi atëherë momenti i dytë i rendësishëm i sugrimit të organizatës me stafin e nevojshëm është procesi i seleksionimit të kandidatëve të cilët i plotësojnë më së miri kushtet për realizimin e punëve në vendet e tyre. Dmth seleksionimin duhet kuptuar si proces të aplikimit të kritereve të caktuara për zgjedhjen e kandidatëve më të mirë të cilët janë ofruar nga tregu i punës. Zgjedhja e mirë e punonjësve kontribuon në produktivitetin e organizatës, përderisa një seleksionim jo i mirë rrit kostot e e transferimit si dhe mund të qojë në largimin e punonjësve për arsye të mospërshtatjes me vendin e punës ku ai është caktuar. Intervistat dhe testet janë disa prej metodave për mbledhjen e informatave për kandidatët gjatë seleksionimit.

MSC. Marjeta Përlala

MODULI: “MANAXHIM BIZNESI”

Leksioni nr. 7: “Elementet bazë të planifikimit”

Në leksionin 7 “Elementet bazë të planifikimit”, do të trajtoheprocesi iplanifikimit dhe rëndësia e saj në organizatë.

Planifikimi konsideron tre dimensionet e mëposhtme:

1. Dimensioni i përcaktimit
2. Dimensioni i marrjes së vendimeve
3. Dimensioni i së ardhmes

Rëndësia e planifikimit: Planifikimi orienton; Planifikimi promovon kooperimin midis departamenteve të ndryshme dhe njerëzve në biznes; Planifikimi detyron meanxherët të shikojnë drejt së ardhmes; Planifikimi siguron që bizneset të jenë update me teknologjinë; Planifikimi siguron kohezionin; Planifikimi promovon qëndrueshmërinë.

Rëndësia e objektivave: Ato sigurojnë orientim për çdo njësi në biznes; Objektivat kanë impakt edhe në aspekte të tjera të planifikimit në organizatë; Objektivat shërbejnë edhe si motivim për njerëzit që ti plotësojnë ato, veçanërisht kur ata shpërblehen nëse arrijnë objektivat për të cilat janë përgjegjës; Objektivat sigurojnë bazën krahasuese (benchmark) për matjen e performancës dhe qëllime kontrolli

Objektivat nuk vendosen në mënyrë autonome. Ato vendosen duke konsideruar katër faktorët që formojnë bazat e planifikimit:

- Misioni
- Mjedisi i biznesit
- Vlerat menaxheriale
- Eksperienca e menaxhimit

Kërkesat fillestare për përcaktimin e objektivave: Menaxhimi duhet të kuptojë rëndësinë e objektivave; Objektivat

duhet të jenë të matshme; Përgjegjësdia për arritjen e objektivave duhet të jetë përcaktuar qartë; Objektivat duhet të vendosen në mënyrë konsistente; Objektivat duhet të jenë të integruara me sistemin e shpërblimit; Menaxhimi duhet të sigurohet që vartësit i pranojnë objektivat.

Planifikimi strategjik. Hartohet nga top management për periudha nga 3-10 vjet ose edhe më shumë, fokusohet tek binznesi si i tërë, është i orientuar drejt së ardhmes, parashikon një adaptim konstant me mjedisin, nuk fokusohet tek detajet por tek guidat e përgjithshme të zhvillimit, menaxhimi përpiqet në mënyrë konstante për të siguruar resurset dhe aftësitë optimale midis mundësive dhe risqeve në mjedisin e biznesit.

OPSIONET E STRATEGJIVE AFATGJATA: Strategjia e koncentrimit; Zhvillimi i tregut; Zhvillimi i produktit; Novacioni; Integrimi horizontal; Integrimi vertical; Joint-venture; Diversifikimi; Racionalizimi; Falimentimi; Likuidimi.

Planifikimi afat-shkurter njihet ndryshe edhe me emrin planifikim operacional. Bëhet për periudha jo më shumë se një vit. Zhvillohen nga menaxherët e nivelit të ulët për arritjen e objektivave operacionalë. Konsiderohet si një komponent i planeve funksionale. Merret me performacën ditore të objektivave dhe alokimin e resurseve, në përputhje me një program të veçantë. Buxhetimi është metoda kryesore që përdoret nga menaxhimi për planifikimin dhe alokimin e resurseve tek planet alternative të veprimit

Implementimi i planit, vëmendja përqëndrohet tek disa aspekte të tre elementeve të tjera të menaxhimit në fazën e planifikimit. Kjo nënkupton që planifikimi, organizimi, drejtimi dhe kontrolli nuk ushtrohen në pavarësi nga njeri-tjetri. Implementimi i planit duhet të planifikohet në të gjitha fazat e procesit.

MSC. Marjeta Përlala

MODULI: “MANAXHIM BIZNESI”

Leksioni nr. 9: “Manaxhimi i punonjësve, organizimi i punës”

Në leksionin 9 “Manaxhimi i punonjësve, organizimi i punës”, do të shohim se si një organizim efektiok i punonjësve ndikon pozitivisht në efeciencën dhe produktivitetin e organizatës, kompanisë.

Njerëzit, duhen konsideruar për organizatën si një burim vlerash e jo si shpenzim, ato janë capital për të.

Kapitali human: Punonjës e një organizate, të përshkruar në terma të trajnimit, eksperiencës, gjykimit, inteligjencës, marrëdhënies dhe karakteristikave të tjera që mund të shtojnë vlerë ekonomike në organizatë.

Në një organizatë rëndësi të madhe ka dhe struktura organizative, nëse ajo është e përcaktuar drejtë dhe saktë ndihmon në organizimin e punës si duhet në të.

Struktura organizative është e rëndësishme sepse përmes saj përzgjidhet se si burimet dhe funksionet do të bashkëveprojnë që të arrihen objektivat e ndërmnarrjes;

Struktura organizative e drejton dhe orienton ndarjen e punëve, përgjegjësinë, detyrimet, vendimmarrjen dhe kompetencat;

Mënyra se si ndërmarrja është organizuar ka ndikim të drejtëpërdrejtë në rendimentin e punës dhe motivimin e secilit punëtorë. Udhëheqësi i ndërmarrjes duhet të krijojë një organizim të punës që shpie në përmbushjen e qëllimeve edhe të punëtorit edhe të ndërmarrjes, në tërësi, kjo duhet të jetë në simbiozë me qëllim mirëfunksionimin e saj.

Struktura e organizimit funksionon si mjet menaxhimi kur kemi të bëjmë me bashkërënditjen e resurseve të ndërmarrjes dhe funksioneve të ndryshme të saj:

- Prodhimi;
- Blerja;
- Magazinimi;
- Shitja;
- Marketingu;
- Administrimi i çështjeve ekonomike dhe personelit.

Në firmat private me vetëm një pronar shpesh është një person që bën punën organizative. Rritja e ndërmarrjes dhe numrit të punëtorëve paraqet nevojën e organizimit. Çdo ndërmarrje, duhet të ketë një organizim sado e vogël në numër është. Skema organizative pasqyron në mënyrë skematike organizimin e ndërmarrjes sipas ndërtimit hierarkik.

Funskionet (aktivitetet) e Manaxhimit të Burimeve Njerëzore

- Organizimi (Projektimi) i punës;
- Planifikimi i BNJ;
- Rekrutimi;
- Seleksionimi;
- Formimi (trajnimi) dhe Zhvillimi;
- Manaxhimi i përformancës;
- Shpërblimi;
- Marrëdhëniet e punës.

Objektivat e organizimit të punës sipas natyrës;

- Rregullimi i detyrave dhe i roleve të punës;
- Trajtimi mekanik, ose teknik;
- Trajtimi human ose motivues;
- Rregullimi i roleve;
- Përcaktimi I Standarteve të punës;
- Rregullimi i orareve;
- Rregullimi i kushteve të punës.

Veprime të organizimit të punës:

- Përcaktimi i mënyrave të strukturimit apo të rigrupimit të punëve në njësi administrative;
- Zgjedhja e teknologjisë së përshtatshme për realizimin e punës;
- Rregullimi i punëve (detyrave) dhe i raporteve midis vendeve të punës (Apo roleve);
- Caktimi i ngarkesave fizike dhe mendore;
- Rregullimi i orareve të punës;
- Rregullimi i vendit të punës.

Objektivat e organizimit të punës

Ekonomik

- Eficienca, efikasiteti

Sociale

- Ruatja e shendetit;
- Kënaqësia në punë;
- Koordinim i punës me jetën private;

Juridike

- Respektimi i kuadrit ligjor

(Kodi i punës, Ligji i nëpunësit civil, vkm-të e ndryshme, rregulloret e brendshme e çdo akt tjetër ligjor).

MSC. Marjeta Përlala

MODULI: “MANAXHIM BIZNESI”

Leksioni nr. 10: “Si të hartojmë një plan biznesi”

Në leksionin 10 “Si të hartojmë nja plan biznesi”, është tepër e rëndësishme të kemi njohuri në artimin e një plani biznesi pasi nëse edhe nuk jemi të përfshirë në mënyrë direkte në një biznes, tërthorazi jëmi grup interesi në përditshmërine tonë, qoftë si punonjës apo edhe si konsumator.

Një Plan Biznesi duhet të jetë:

- Me kuptim dhe bindës;
- I strukturuar qartë;
- Lehtësisht i kuptueshëm;
- I shkurtër.

Në përmbledhjen ekzekutive të Planit të Biznesi duhet të ketë informacion në lidhje me pikat e mëposhtme:

- Emri i Biznesit
- Struktura e Biznesit
- Vendndodhja e Biznesit
- Data e Themelimi
- Pronari (et) e biznesit
- Përvoja Relevante e Pronarit
- Produktet/Shërbimet:

TREGU, është një ndër sesionet më të rëndësishme të zhvillimit të planit të biznesit, duhet të fokusohemi në:

- Rajoni i tregut
- Klientët
- Vlera për konsumatorin
- Vëllimi i shitjeve

PRODUKTET/SHËRBIMET. Duhet te përshkruhen produktet ose shërbimet qartë se çfarë nënkuptoni me to. Të shpjegohet se si do të fillohet me një produkt minimal të qëndrueshëm dhe hap pas hapi se si do të zhvillohet ai dhe idenë përfundimtare të biznesit.

KLIENTËT E SYNUAR Të përshkruhet lloji i klientëve që synohet (bizneset e tjera ose konsumatorët e drejtpërdrejtë, mosha tipike dhe të ardhurat e tyre). Të përshkruhet shkurtimisht faktet kryesore në lidhje me profilin e klientit dhe të shtohet nëse ata do të jenë më shumë në të ardhmen.

MADHËSIA E TREGUT Cila është zona për të cilën do të shitet dhe cila është sasia totale e produkteve dhe shërbimeve të ngjashme në zonë? Nëse produktet/shërbimet janë të reja për këtë zonë, të deklarohet kërkesa e pritshme dhe të shpjegohet se si do të arrihet në këtë shifër të kërkesës.

Të përshkruhet madhësia e tregutj. Madhësia e tregut mund të matet në bazë te disa variablave:

- Tregu aktual i kompanisë, tregu i brendshëm për tipologjinë e prodhimit/shërbimit
- Numri i klientëve potencialë
- Shpenzimet totale për produkte të ngjashme (Shuma e paguar në vlerë për produkt/shërbim të ngjashëm të blerë në tregun target)
- Numri total i njësive të produkteve të ngjashme të shitura. (Shuma në sasi e produkt/shërbim të ngjashëm të shitur në tregun target)
- Identifikimi gjeografikisht i tregut të synuar (Internacional, Nacional (Lokal, Qytet, Njësi administrative etj.))

Të perdoret analiza e të dhënave analitike si raportet e tregut nga organizata apo studime të ndryshme, informacionet nga ana e dhomave apo partnerve të sektorit privat, statistikat, sondazhet, etj. Përcaktimi i madhësisë së tregut për produkt/sherbimin tuaj, të klasifikuara sipas segmentimit të tregut të synuar (demografik, gjeografik, gjini, moshë etj), nëse është e mundur. (Për të dhëna mund të perdoren burime si INSTAT, Statistikat e Bashkimit EU Eurostat, etj,)

Janë dy metodat kryesore:

1. Metoda sasiore. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave, nëse nuk ka burim për të dhëna analitike për të studiuar ose për të aplikuar statistika, një sondazh është gjithmonë një opsion efikas
(Google është një instrument shumë i mirë për sondazhet)

2. Metoda cilësore, kemi të bëjmë me përpunimin e një informacioni më analitik, por janë mendime, observime etj... grupet e fokusit, intervistat ose vëzhgimet japin informacion në lidhje me zakonet e shpenzimeve, nevojat e konsumatorëve, etj.

3. Paraqisni trendin e mëparshëm dhe faktorët kryesore që kanë ndikim në rritjen e tregut sot dhe në të ardhmen duke përfshirë trendin e industrisë, ndryshimet në popullsi, trende sociale, politikat etj.

4. Prodhimi i brendshëm, importi i produkt/shërbime. Të krijohet një ide e bilancit tregtare për të kuptuar se cila është përthithja e tregut.

5. Krijimi i një baze të dhënash për kërkimin e partnerve potenciale, duke krijuar mundësinë që kompa-

nia të ketë një faze operative që në momentet e para.

6. Analiza e sektorit, rekomandime, konkluzione.

Konkurentët janë një ndër elementët kryesorë të Planit të biznesit, e cila kërkon një nalizë të mirëfilltë para se të futemi në treg. Analiza e konkurencës do të ndale në disa oika si më poshtë:

- Aktorët lokal në sektor, prodhuesit, ofruesit e shërbimit, firmat importuese sipas kategorive të produkteve dhe volumeve
- Produkte / shërbimet për konsumatorët/klientët të ofruara nga konkurenti më i ngjashëm
- Markat dhe firmat e produkteve të prodhuara apo importuara
- Firmat me gamë të ngushtë produkti në zonën tuaj
- Firmat me gamë të gjerë produkte/shërbime në rang vendi
- Tendencat e konsumit të produktit/shërbimit në zonë/vend
- Distribucioni dhe facilitetet shpërndarëse e magazinuese
- Reklama dhe promocioni (firmat në vend)
- Rikonceptimi i sektorit të shitjeve

MARKETINGU, sot edhe më shumë po bëhët edhe më I rëndësishëm për kompaninë, madje I domosdoshëm për të.

SHITJET UNIKE Kjo është më të vërtetë e rëndësishme! Të përshkruhet çfarë e bën dallimin midis ofertës të produktit / shërbimit nga konkurrentët. Cilat janë përfitimet që i ofrohen klientëve dhe të tjerët jo? Mos të dilet në konkluzionin “cilësi më e mirë - çmim më i ulët”. Kjo nuk është as një strategji e marketingut dhe as çfarë konsumatorët besojnë se është e vërtetë.

MSC. Marjeta Përlala

MODULI: “MANAXHIM BIZNESI”

Leksioni nr. 11: “Kwrkimi shkencor”

Në leksionin 9 “Kërkimi shkencor”, marrja e një informacioni të saktë e të vlefshëm kërkon të plotësohen disa procedura dhe standarte.

Cfarë është Shkenca? Një grup metodash të përdorura për të, grumbulluar informacionin rreth një fenomeni në një fushë të caktuar, duke ndërtuar një bazë të besueshme informacioni në një fushë të caktuar dhe duke zhvilluar teori që shpegojnë një fenomen;

Informacioni i nevojshmëm për Kërkim është të identifikosh një problemi për të studiuar; të zhvillosh hipoteza; të kryesh kërkim dhe analizim të rezultateve; të përhapesh rezultatet.

Kush është kërkuesi shkencor? Studiuesi? Kur mendon për kërkuesin mendon për dikë që rri në laborator, mbi libra, në bibliotekë? Jo Kërkuesi është kushdo që ka një pyetje, një problem, një cështje dhe do të marri informacion të besueshëm dhe të saktë mbi një temë të caktuar. (Jo të bazuar në thashetheme).

Një person i cili bën shkencë: Adopton metoda shkencore për të marrë informacion; Përfshihet në një grup të madh aktivitetesh; Punon në një varietet ambientesh.

Shkenca është një mënyrë për të menduar. Përcakton në mënyrë të kujdeshme një problem; Kërkon informacione të rëndësishme; Teston hipotezën në mënyrë rigoroze; E bën një person skeptic mbi median popullore.

Pse na duhet kërkimi shkencor?

Kërkim Shkencor është i vetmi burim i besueshëm informacioni të cilin e marrim duke lexuar nga raportet e të tjerëve. Ti beson në ato që lexon deri sa nuk është provuar e kundërta. Gjithmonë duhet të jemi skeptik për ato që lexojmë por është e vetmja mënyrë për të marrë një informacion. Pa kërkim shkencor të publikuar, njerëzit do të ishin të mbyllur e të izoluar në opinionet e tyre të momentit, të burgosur në eksperiencat vetjake dhe ‘budallepsur’ nga ato që i thonë të tjerët. Shembull: Cfarë di për Tiranën? Po për Venusin?

Ti je i ekspozuar ndaj kërkimit çdo ditë:

Kontradita shkencore;

Sondazhe shkencore;

Informacione mbi kurat e reja shëndetësore;

Reklama për të blerë një produkt.

Ti duhet të dish mbi kërkimin shkencor për të përballur me cështjet e kërkimit të përditshëm. Është gjithmonë me fit-imprurëse të dish se si kërkohet edhe pse nuk merresh me fushën e kërkimit.

Të bësh kërkim nuk do të thotë të besosh, do të thotë gjith-monë të dyshosh.

"Nuk ka njohuri pa pasur dyshim"

William V. O. Queen

Njohuritë ndryshojnë nga opinioni dhe të gjitha tipet e tjera të marrjes së informacionit si intuita, tradita, authoriteti, besimi, etj...

"Të gjitha të vërtetat hidhen poshtë"

William V. O. Queen

Kërkim "Metodë grumbullimi, marrje njohurish, një mënyrë për të mësuar dhe kuptuar botën që na rrethon". (Earl Bab-bie, The Practice of Social Research, 2009)

Çfarë është kërkimi shkencor?

Shembull: Pyetje, Problem: Çfarë është Arkitektura?

Kërkim: Futesh në Google, lexon informacione, shef foto, kërkon libra, lexon artikuj, shkrime etj.

Në kuptimin e gjerë: kërkimi është grumbullimi i informa-cionit për t'ju përgjigjur një pyetjeje që zgjidh një problem.

"Praktika pa teori është e verber, Teoria pa praktike është e pafuqishme."

Emmanuel Kant

"Formulimi i një problemi është aq esencial sa dhe zgjidhja e tij. Ngre pyetje të reja, mundësi të reja, shikon problemet

e vjetra me një këndvështrim tjetër të ri, me një imagjinatë krijuese dhe ky është një kërkim shkencor dhe një input për shkencën dhe shoqërinë"

Einstein et Infeld

Kërkimi është një mënyrë kundërshtimi.

Kërkimi është ajo që unë dua të di, jo ajo që dua të bëj.

Kërkimi nuk ka pse të jetë praktik, por teorik, mbledhës njohurish.

"Një koleksion metodash dhe metodologjish që kërkuesit aplikojnë sistematikisht në mënyrë për të prodhuar njohuri të bazuara shkencore rreth botës sociale".

Neuman

Kërkimi është një mënyrë e organizuar:

- Ka një strukturë dhe një metodë të caktuar se si bëhet kërkimi.
- Është një procedurë e planifikuar dhe jo një spontane.
- Është e fokusuar dhe e limituar për një qëllim të caktuar.

Kërkimi është mënyrë e organizuar dhe sistematike:

- Pasi ka një sërë rregullash e procedurash dhe hapash që ti ndjek dhe ka disa gjëra në një proces kërkimi që ndjekin një llogjikë dhe një renditje të caktuar në mënyrë që ti të marrësh rezultatet e duhura

Kërkimi është mënyrë e organizuar dhe sistematike për të gjetur përgjigjet

- Pasi gjithcka bëhet për të gjetur një përgjigje ose disa përgjigje në kërkimin tënd, për të zbuluar një zgjidhje a një njohuri. Shpesh përgjigja mund të jetë edhe JO por kjo është përsëri një përgjigje që ti duhet ta gjesh.

Kërkimi është mënyrë e organizuar dhe sistematike për të gjetur përgjigjet ndaj pyetjejeve.

- Janë thelbi i kërkimit, pasi nëse nuk do të kishte pyetje nuk do të kishte kërkim. Kërkimi bazohet në pyetje të rëndësishme, të vlefshme dhe të përdorshme. Pa pyetje kërkimi nuk do kishte fokus, thelb, qëllim.

MSC. Marjeta Përlala

MODULI: “MANAXHIM BIZNESI”

Leksioni nr. 12: “Rishikimi i një studimi (shkrimi), formatimi”

Në leksionin 12 “Rishikimi i një studimi (shkrimi), formatimi”, do të shohim me kujdes se si një shkrim duhet të shkruhet për të qënë i kuptueshëm, i qartë, i saktë dhe konciz për lexuesin.

Më poshtë gjenden tre paragrafe të cilat shprehin të njëjtën gjë, por mënyra e të shkruarit ndyshon,

Paragrafi 1:

Një specifikim shumë preçiz i nevojave të procesit të informacionit, do të sillte një rrezik të mbivlerësimit ose nënvlerësimit nga ana e vendimarrësve, duke rezultuar në përdorim joefektiv të burimeve të shpenzuara. Por shumë pak precision në specifikimin e proceseve të kapaciteteve nuk do të indikonte saktë procedurat e burimeve të nevojshme.

Paragrafi 2:

Një person që merret me vendimarrje nganjëhere specifikon atë cfarë ai ka nevojë për të përpunuar informacionin. Ai mund ta bëjë këtë shumë preciz. Ai mund ti mbivlerësojë ose nënvlerësojë burimet që ai kërkon. Kur ai bën këtë ai mund të përdori burimet në mënyrë të shpenzueshme. Por nëse ai nuk e bën këtë në mënyrë precise ai mund të mos tregojë se cilat burime duhen.

Paragrafi 3:

Kur një vendimarrës nuk i specifikon shumë saktë burimet që ai ka nevojë për të përpunuar informacionin, ai mund të nënvlerësojë ose mbivlerësojë ato, duke i përdorur në mënyrë joefikase e të shpenzueshme burimet. Por nëse nuk i specifikon mjaftueshëm, ai mund të mos tregojë se cilat burime i nevojiten.

Si mendoni që duhet të shkruhet paragrafi i mësipërm?

- Si paragrafi nr. 1;
- Si paragrafi nr. 2;
- Si paragrafi nr. 3;
- Apo mendim tjetër...

Perzgjedhja e stilit, kur nis të shkruash është mirë të hed-

hësh mendimet si të vijnë e më pas tu kthehesh e t'i lexosh ato, duke i rishikuar në mënyrë që të gjesh një stil sa akademik po aq edhe të qartë e të kuptueshëm.

Rregulli I

Vendos kryefjalen si karakter personazhi kryesor në fjalinë tendë. Subjekti (kryefjala duhet të jetë e shkurtër, precise, specifike).

1- Joni përsërit vazhdimisht veten sepse...

2- Arsyeja që Joni përsëriste vazhdimisht veten qëndronte në faktin se ...

Rregulli II

Kthe foljet në emra, mbiemra etj...

1- Përzgjedhja e stilit.

2- Kërkim Shkencor.

3- Etikë Profesionale

Formatimi i një kërkimi shkencor është i vështirë.Nëse artikulli nuk shkruhet në gjuhën akademike ai nuk mund të merret seriozisht.

Të kërtkosh ndihmë pasi të kesh mbaruar shkrimin e një studimi të ndihmon jo vetëm në kontrollin e gabimeve drejtshkrimore dhe gramatikore, por dhe në përçimin e mesazhit. Kërko ndihmë!

Gramatika. Në një studim shkencor, mbi të gjitha artikulli dhe shkrimi duhet të jetë gramatikisht i saktë, dhe korrekt. Duhen përdorur shenjat e duhura të pikësimit.

Gjuha pasive , Për momentin kërkuesit përdorin zërin pasiv që do të thotë "është zbuluar se...", "rezultatet tregojnë se...", në vend të "kemi zbuluar se...", ose "unë gjeta se...".

Duke qenë se ti i drejtohesh një grupi kërkuesish me shkrimin tënd, është mirë të përdoret veta e tretë dhe asnjëherë veta e parë njëjës ose shumës.

Përdorimi i gjuhës pasive do të thotë që këto nuk janë mendimet e tua, por ato që dalin nga studimi, janë deklarata të bazuara shkencore.

Stili APA (American Psychological Association)

Stili duhet të ndjekë këto rregulla:

- Marxhinat- të gjitha marxhinat në të majtë dhe në të djathtë, sipër edhe poshtë duhet të jenë secila vetëm 1 inch.
- Madhësia dhe tipi i shkrimit- gjatë gjithë artikullit duhet të jetë shkrimi 12, ose 11 me Times Neë Roman. (Shkrim i unifikuar për gjithë studimin)
- Hapësira- (Double space)- Shkrimet duhet të jenë me hapësire 2 fishe përgjatë gjithë tekstit, shtojcave, shënimeve, tabelave, figurave.
- Orientimi i tekstit. Orientimi duhet të jetë në të majtë duke e lenë marxhinën e djathtë pa orientim preciz.
- Nëntitujt, duhet të jenë jo më shumë se 50 karaktere bashkë me pikësimet dhe duhet të vendosen në të majtë.

- Fleta e titullit. Përmban titullin, nëntitullin dhe emrin e autorit ose të autoreve të tjerë si dhe institucionin që përfaqëson. Duhet në qendër të fletës, me hapesirë dyshe mes rreshtave.
- Abstrakti – duhet të jetë 150-250 fjalë shkruar në formatin bllok, numrat që përfshihen në abstrakt duhet të jenë të shkruara me numra dhe jo fjalë vetëm nëse nis fjalia me numër.
- Trupi i studimit- i gjithë teksi i shkruar në të majtë. Cdo fillim paragrafi duhet të jetë i spostuar 5-7 hapësira nga e majta.

Referencat, në çdo shkrim duhet me patjetër të citohen referencat dhe mënyra e të shkruarit të tyre është shumë e rëndësishme.

- **Për librat;**

SARGENT, J.R. (1995); Origins and functions of lipids in fish eggs: Nutritional implications. Found in; Broodstock management and egg and larval quality, Edited by Bromage, N.R. and Roberts, R.R, pp 353 - 372, Blackëell Science, Oxford, 1st Ed

- **Për artikuj;**

NAVARRO, J.C. AMAT, F. SARGENT, J.R. (1991) A study of the variations in lipid levels, lipid class composition and fatty acid composition in the first stages of Artemia sp. Marine Biology, Issue 111, pp 461 - 465.

- **Për website;**

http://en.wikipedia.org/wiki/Artemia (2006).

- Referencat për intervista;

SARGENT, J. R., (2007), komunikim personal.

Nëse referencat janë në tekst ka dy mënyra: (Sargeant, 2007) në fund të fjalisë. Sargent (2007), zbuloi se ....

Ka raste që duhet edhe numri i faqes (Sargeant 2007, 17)

Nëse është shkruar nga një organizatë... NHS (National Health Service), WHO (World Health Organization), etj.

Nëse e ka thënë dikush tjetër dhe ti e ke gjetur nga një burim tjetër (Sorgheloos, 1967, cituar sipas Sargeant, 2008).

... përbërja e acidit. (Sargeant, 2007).

... u zbulua nga zhvillimi. (Clayton, 2000).

Mënyra të tjera të të shkruarit të referencave mund të jenë

Sargeant (2007) zbuloi që kompozimi i acidit....

Clayton (2000) deklaroi që zhvillimi....

Gjithmonë duhet të perdoret koha e shkuar:

Smith (2000) ka deklaruar që ...

Smith (2000) deklaroi që...

Titujt duhet të jenë me shkronja kapitale në secilen nga fjalet kryesore.

Clean – Soil;

Air;

Water Sociology of Religion;

There Is Nothing Left to Lose ëriting;

New Media;

Natural-Born;

Harry Potter.

Kuotimet, nëse kuotimet janë të shkurtra vendosen në thonjëza. Sipas Clayton (2000), “Disa lumenj përvec Thamës që intersektohen në Londër, janë mbuluar prej zhvillimit urban” (fq.28).

Nëse nuk përmendet emri i autorit përgjatë citimit duhet të vendoset emri i tij në fund. “Disa lumenj pervec Thamës që intersektohen në Londër, janë mbuluar prej zhvillimit urban” (Clayton,2000, fq.28)

Nëse kuotimet janë më të gjata se sa 40 fjalë duhet të vendosen në një bllok dhe kuotimi duhet të fillojë në një fjali tjetër. Jones’s (1998) study found the folloëing: Students often had difficulty using APA style, especially ëhen it ëas their first time citing sources. This difficulty could be attributed to the fact that many students failed to purchase a style manual or to ask their teacher for help. (p. 199)

Parafrazime, nëse ti do bësh përmbledhje ose parafrazim duhet të përmendësh gjithashtu emrin e autorit dhe vitin.

Stili APA mendon se është më mirë edhe faqja por kjo është relative.

According to Jones (1998), APA style is a difficult citation format for first-time learners. APA style is a difficult citation format for first-time learners (Jones, 1998, p. 199).

- Lista e referencave përfshin gjithë informacionin e nevojshem që duhet për lexuesin për të gjetur bibliografinë që ti ke perdorur.
- Cdo reference që ti ke cituar duhet të futen në listën e referencave dhe është e rëndësishme të ketë disa rregulla në të shkruarin e tyre.
- Emërtimi. Lista e referencave quhet –Referencat- dhe nuk duhet të jetë as italike, as Bold e as e nënvizuar, ose në thonjeza
- Hapësira. Cdo tekst duhet të ketë hapësire dyfishe nga rreshti në rresht.
- Spostimi. Të gjitha rreshtat që vijnë më pas rreshtit të parë të listës së referencave duhet të jenë të spostuara gjysëm inch nga marxhina majtas.
- Renditja. Të gjitha refrencat duhet të renditen me rregull alfabetik. Ku mbiemri i autorit është gjithmonë përpara emrit.

Kur kemi deri në 5 autore jepen mbiemrat e secilit dhe inicialet e semrit të secilit.

Nese kemi mbi 5 autore vendoset emri i të parit dhe shoqërohet me shënimin et al.

MSC. Marjeta Përlala

MODULI: “MANAXHIM BIZNESI”

Leksioni nr. 13: “Komunikimi në Biznes dhe kuptimi i Etikës”

Në leksionin 13 “Komunikimi në Biznes dhe kuptimi i Etikës”, jo vetëm një komunikim efektiv rrit eficiencën dhe produktivitetin e organizatës, por etika dhe kodi i saj sot në biznes po bëhet gjithmonë e më i rëndësishëm dhe i domosdoshëm.

Marrja e vendimeve etike është relativisht më e thjeshtë kur njihen të gjitha faktet, ngjarjet dhe situatat.

Kur informacioni mungon apo kur ka çështje të ndryshme, rezulton të këmi vështirësi dhe deri në konflikt. Si duhet të reagojmë ndaj paqartësive dhe të marrim vednimin e duhur etik kur çështjet janë të paqarta?

Etika ka të bëjë me marrjen e vendimeve të duhura dhe shmangien e atyre të gabuara. Parimet etike trajtojnë problem të ndreshmërisë, shërbimit, cilësisë, integritetit, sensibilitetit, finesës dhe dinjitetit.

Secili nga ne çdo ditë merr vendime, duke ndërtuar në ndërgjegjën tonë konceptet e të drejtës dhe të gabuarës duke formuar disa parime të caktuara të etikës sonë.

Shembull: *“Gjatë një interviste pune, pyeteni se pse ju duhet të merreni në punë dhe jo një kandidat tjetër, që e supozojmë që është shoku, miku juaj I ngushtë. Nëse keni disa informacione negative mbi këtë person çfarë do të bënit, do t’ia tregonit apo jo intervistuesit?”*

Një përgjigjje e shpejtë do të ishte që ne gjithmonë zgjedhim vendimin e duhur në përputhje me moralin shoqëror, çfarë do të thotë se një përgjigjje mund të ishte: “Miqësia duhet të triumfojë mbi përfitimin personal”.

- është vendim i drejtë dhe moral?
- Në çfarë rrethanash do të vepronit ndryshe?
- Pse mos ia tregojmë intervistuesit informacionin në lidhje me kanditatin konkurrentë?
- Bota sot bazohet në konkurrencë?!

Vënia e ngjarjeve etike në një kontekst më të gjerë do të ndryshonte mënyrën në të cilën ne e përceptojmë këtë ngjarje.

Një përgjigjje e prerë nuk është gjithmonë e saktë.

Manaxheri, apo çdo profesionist ballafaqohet me dilemma të ngjashme etike. Manaxheri, apo çdo profesionist është mirë të testohen për atë çfarë ata gjykojnë si të drejtë dhe çfarë si të gabuar. Të marrësh dhe të japësh mendime në raste të ndryshme konkrete do të ishte frytdhënëse.

Shembull: "Administratori I një hoteli kohët e fundit ka blerë 20 arka me verë nga një furnitor I ri. Furnitori, pa dijeninë e administratorit I shpie një arkë vere falas në shtëpinë e këtij të fundit. Administratori vendos ta mbajë arkën e dhënë për konsum personal pasi ai mendon se marrja e kësaj arke nuk ka influencuar në vlerën e blerjes së 20 arkave të hotelit."

Si mendoni, a jeni dakort me gadishmërinë e administratorit për të mbajtur arkën e verës?

Shumë prej nesh mund të mendoj se është e gabuar mbajtja e arkës së verës nga ana e tij.

Shumë prej nesh mund të mendoj se nuk është e gabuar pasi ai marrjen e arkës së verës e mendon si një dhuratë, nga ana e furnitorit.

Vendimi është etik?

Ne nuk jemi qënie njerëzore që kemi një eksperiencë shpirtërore, por jemi qënie shpirtërore që kemi një eksperiencë njerëzore. Ne identifikohemi në sytë e të tjerëve me mënyrën se si sillemi, duke ua komunikuar vlerat dhe besimet tona me anë të sjelljeve verbale dhe jo-verbale. Për të maksimizuar vlerat e një organizate, njësie ekonomike punonjësit duhet të sillen në mënyrë te tillë që të promovojnë ndershmëri dhe drejtësi.

Drejtuesit, menaxherët, pronarët janë ata që caktojnë një linjë etike për biznesin. Veprimet e tyre tregojnë vlerat e njësisë ekonomike, nëse ajo është e korruptuar, e manipuluar dhe pre e devijimeve të ndryshme, apo është e hapur e ndershme dhe gatshme për të pranuar dështimet e mundshme. Menaxherët, drejtuesit, pronarët duhet të shprehen dhe jo të heshtin, kur diçka nuk shkon mirë në kompani. Duhet të jenë ata përsonat që influencojnë të tjerët për të përcaktuar linjën e etikës që duhet ndjekur. Shpeshherë ne mund të dimë se çfarë është është e mirë apo çfarë është e keqe, por na mungon forca e brendshme ose ndenja kolektive që roforcon veprimin në mënyrë etike. Vëzhgimi i njerëzve të tjerë që bëjnë veprime të duhura etike shërbejnë si frymëzues edhe për ne, duke na motivuar të bëjmë të njëjtën gjë.

Komunikimi etik në arenën e biznesit është një sfidë që duhet përballuar në një sërë nivelesh. Çështjet ligjore kanë një ndikimi shumë të madh si tek individi ashtu edhe tek organizata që i mbart. Sfidat organizative përfshijnë ndërtimin e një culture productive në një kompani me të punësuar që kanë formim, vlera dhe besime të ndryshme. Në të gjitha këto sfida, sistemi personal I vlerave do të ndikojë në sjelljen e vendim-marrësit po aq sa dhe të personave që e rrethojnë.

MSC. Marjeta Përlala

MODULI: “MANAXHIM BIZNESI”

Leksioni nr. 14: “Punë praktike krijimi i një biznesi”

Në këtë sesion klasa është ndarë në tre grupoe pune, ku secili nga grupet e punës janë instruktruar në bazë të njohurive të marra deri tani të hartojnë një plan biznesi në miniaturë dhe të krijojnë kompanitë e tyre.

Grupi i parë, pasi punës në grup arriti të prezantonte para klasës planin e ndërtimit të një lokali në Shëngjin i cili do të kishtë në focus promovimin e të gjitha produkteve tradicionale dhe bio të zonës së Lezhës dhe përreth asaj. Gjithashtu ata prezantuan dhe kishin si qëllim dhe marketimin e dokeve dhe traditave zakonore.

Grupi i dytë prezantoi një risi teknologjike për qytetin e Lezhës. Hartimin dhe ndërtimin e një aplikacioni për gjetjen dhe monistorimin e fëmijëve nën moshën 12 vjeç. Kjo sipas prezantimit të planit të biznesit do të pasqyrohej një një program kompjuterik të integruar në telofonin cellular të prindërve. Ky programim do të kishte një kosto mujore mirëmbajtje dhe për këtë arsye sipas planit financiar do të kishte dhe një çmim në shitje, por i cili do të ishte konkurrent duke u bazuar edhe në faktorët ekonomiko kulturor në cilin ndoshte target grupi i synuar për të qënë potencial i këtij programi. Target grupi i synuar ishte ai i fëmijeve dhe jo pa qëllim pasi është një grupmoshë delikate për shoqërinë

Grupi i tretë propozoi krijimin e një agroturizmit në një zonë të thellë të Lezhës, ku mund të provohej jo vetëm zona dhe produktet bio që ajo mbart, por do të ndikonte thellësisht në zhvillimin ekonomik të zonës dhe në vitalizimin e saj. Në të njëjtën kohë pjesë e këtij plani biznesi do të ishte dhe një dyqan ku do të tregtoheshin jo vetëm produketet bio organike të zonës por dhe veshjet apo aksesorët e tjerë popullor tradicional të krahinës. Promovimi dhe risjellja në vëmëndje e elementëve të vjetër tradicional do të tërhiqte konsumator jo vetrëm vendas krahinor, por dhe ndërqytetas pse jo edhe turista të huaj.

Të tre planet u prezantuan dhe u mbrojten me argumenta, dhe pas prezantimit të tyre në klasë, u hodhën në konkurim për të nxierr një fitues, ku u shpall grupi i dytë për risinë dhe fëmëndjen që u kishte kushtuar një segmenti tepër të rëndësishëm për shoqërinë, grupmoshën e fëmijëve.

Ky projekt ka qëllim që deri në fund të modulit të zhvillohet dhe të pasqyrohen edhe element të tjerë të planit të biznesit.

MSC. Marjeta Përlala

MODULI: “MANAXHIM BIZNESI”

Leksioni nr. 15: “Parimet e Komunikimit Efektiv – “Shtatë C-të e komunikimit”

Të gjitha “C-të” mund të aplikohen si për komunikimin e folur edhe për atë të shkruar pikërisht këto do të shikohen në leksionin 15 “Parimet e Komunikimit Efektiv – “Shtatë C-të e komunikimit”.

Për të ndërtuar mesazhe efektive të shkruara dhe gojore, duhet që të aplikohen parime komunikimi të caktuara. 7 “C-të” e komunikimit janë tërësia, konçiziteti, konsiderata, konkretësia, qartësia, kortezia, korrektësia. Këto parime janë të aplikueshme për të gjitha format e komunikimit, që nga fjalët apo fjalitë e thjeshta dhe deri tek dokumentet apo prezantimet e kompletuara. Në mjaft këndvështrime këto parime edhe mund të mbivendosen, pasi bazohen në një preokupim të përbashkët për audiencën, pavarësisht nëse kjo audiencë është e përbërë nga dëgjues apo lexues.

TËRËSIA

Marrësi i mesazhit, qoftë degjues apo lexues, dëshiron informacion të plotë për pyetjet e tij.

- Mesazhi i një biznesi është i kompletuar ku ai përmban të gjitha faktet që i nevojiten dëgjuesit ose lexuesit për reagimin që dëshirohet.
- Tërësia ofron përfitime të shumta:

- mesazhete plota pritet të japing rezultatet e dëshiruara pa shepnzimin e mesazheve shtese;
- Mund të bëjnë një punë më të kënaqshme për të ndërtuar vullnetin e mirë, duke ngjallur dhe interes;
- Komunikimet që mund të duken të parendësishëm mund të jenë tepër të rëndësishëm nëse informacioni që ato mbartin është i plotë dhe efektiv.

Të jesh tërësor duhet të kemi parasysh:

1. **Sigurimin e të gjithë informacionit të domosdoshëm;**

Përgjigjet ndaj 5 “w-ve” (who –kush; what –çfarë; when –kur; where –ku; why –Pse.)

2. **Përgjigjje ndaj të gjithë pyetjeve të bëra;**

Shikohen me kujdes pyetjet, disa prej tyre mund të kupto-

hen me vështirësi, lokalizoni dhe pastaj jepini përgjigjje të sakta.

3. **Dhënia e diçka suplementare kur ajo dëshirohet.**

Përdor logjikën në dhënien e materialit shtesë, në rastet kur mesazhi I dërguesit është I paplotë.

KONCIZITETI

Konciziteti është të shprehurit e asaj çfarë duhet thënë me sa më pak fjalë të jetë e mundur dhe pa sakrifikuar cilësitë e tjera të "C-ve". Konciziteti është një kusht për komunikim efektiv në biznes, pasi kursen kohën dhe shpenzimet si për dërguesin edhe për marrësin. Konciziteti kontribuon në eliminimin e fjalëve të panevojshme, por tregon dhe respect për marrësin dukë mos I "tejngopur" jetën e tyre profesionale me informacione të panevojshme.

Duhet të:

- Eliminohen shprehjet fjalë –shumë;
- Përfshihen vetëm materialet që lidhen me çështjen;
- Shmangen përsëritjet e panevojshme.
- Të përdoren fjalë të thjeshta në vend të frazave të ngarkuara;
- Të fokusohesh fort tek qëllimi I mesazhit;
- Të eliminohen fjalët pa lidhje dhe fjalitë e tejzgjatura;
- Të mos përsëritet që në fillim ajo çfarë është për t'u thënë më parë nga marrësi I informacionit;
- Të shmangen prezantimet e gjata, shpjegimet e panevojshme.
- Të perdoren terma të shkurtra, pas përdorimit më parë të termave të gjatë.
- Përdorimi i përemrave ose inicialeve në vend të emrave të gjatë.
- është e nevojshme që "të spastrohen" të gjitha përsëritjet e frazave dhe fjalive të panevojshme.

KONSIDERATA

Konsiderata është të përgatitesh çdo mesazh duke patur parasysh marrësin e mesazhit. Gjuha dhe përmbajtja e mesazhit duhet adaptura sipas nevojave të marrësit gjatë periudhës që mesazhi është duke u kompletuar.

- Tre mënyra specifike për të treguar konsideratë janë:

1. Fokusimi tek shprehja "JU" në vend të shprehjes "UNë" dhe "NE";
2. Theksimi i përfitimeve dhe interesave që mund të fitojë audience, të cilat duhet të zënë një pjesë të rëndësishme të mesazhit;
3. Theksimi I fakteve positive dhe të kenaqshme, pra përdorimi I termave pozitiv rrit efektivitetin e mesazhit,

rrjedhimisht lexuesit do të reagojnë në një mënyrë të përshtatshme.

KONKRETËSIA

Keqkuptimi i fjalëve ka sjellë treagjedi si në luftë, edhe në paqe, në situate biznesi ose jo.

Të komunikosh konkretisht do të thotë që të jesh specific, përcaktuar dhe i gjallë, në vend që të jesh I vakët dhe I përgjithshëm. Të përdoren fjalë direkte në vend të fjalëve me nënkuptim. Të përdoren fakte, shifra konkrete. Mesazhet konkrete janë më të sakta dhë dinamike. Gjatë diskutimit foljet duhet të bëhen vepruese dhe active. Gjithmonë kur kryefjala "vepron", ndjehet më tepër jetë dhe gjallëri.

QARTËSIA

Qëllimi i qartësisë është "nxjerrja" e kuptimit nga mendja e një individi dhe "transferimi" I tij në mendjen e lexuesit (e bërë kjo sa më saktësisht).

- **Për të qënë sa më qartë nevojitet:**

Të zgjidhen fjalët sa më preçize, konkrete dhe të njohura.

(Kur ka paqartësi është mirë që të perdoren më shumë fjalë të njohura. Audienca do t'I kuptojë ato më mirë.)

Të ndërtohen fjali dhe paragrafë sa më efektive.

(Vini më shpesh idetë kryesore në fillim të një fjalie.)

KORTEZIA

Njohja e audiencës lejon që të përdoren shprehjet e përshtatshme të politesës. Për këtë arsye informohuni mirë mbi marrësin e mesazhit.

Kortezia, apo politesa e vërtetë përfshinë jo vetëm marrjen në konsideratë të mendimeve të të tjerëve por dhe ndjenjat e tyre. Ajo karakterizohet nga një qëndrim respektues ndaj të tjerëve. Kortezia është edukatë që rritet nga respekti dhe preokupacioni për të tjerët. Në çdo shkrim apo komunikim duhet të manifestohen sjelljet me kortezi dhe politesë.

KORREKTËSIA

Në thelb të korrektësisë është përdorimi I rregullave gramatikore, I shenjave të pikësimit dhe të mënyrave të shqiptimit. Një mesazh mund të jetë gramatikisht dhe mekanikisht perfekt, por përsëri mund të jetë diskriminues duke sjellë për shembull largimin e një klienti nga një biznes

MSC. Marjeta Përlala

MODULI: “MANAXHIM BIZNESI”

Leksioni nr. 16: “Konflikti dhe negocimi “Në biznes nuk arrihet ajo që do, por ajo që negocion”

Në leksionin 16 “Konflikti dhe negocimi “Në biznes nuk arrihet ajo që do, por ajo që negocion”, do të trajtohet rëndësia e negocimit në funksionimin e biznesit dhe në maksimizimin e fitimit.

Nëse dy njerëz në të njëjtën punë janë dakord me njëri – tjetrin tërë kohën, atëherë njëri është i panevojshëm, por nëse nuk janë dakord tërë kohën atëherë të dy janë të panevojshëm.

Konflikti është aspekt i paevitueshëm i jetës, në organizatë, i ndikuar edhe nga prirjet kryesore të ditëve të sotme.

- *Ndryshimi konstant;*
- *Diversiteti I madh I punonjësve;*
- *Disa grupe pune;*
- *Më pak komunikim ballë për ballë (më shumë ndërveprim elektronik);*
- *Ekonomi globale me lidhje tregtare në rritje mes kulturash të ndryshme.*

Të mësosh si të menaxhosh konfliktin është një investim me vlerë që na përmirëson ne si individ, familjet dhe organizatat tona, të përshtatemi dhe të përfitojmë nga ndryshimi. **Konflikti është procesi në të cilin një palë perepton se interesat e saj, po kundërshtohen apo cenohen negativisht nga pala tjetër.** Konceptim na bën të mendojmë se burimet e konfliktit janë reale ose imagjinare. Konflikti mund të shihet edhe si një cikël në të cilin evidencojmë shkaqe, procesin bazë në të cilin kemi ndërveprim të palëve dhe rezultatet. Menaxherët apo çdo kush duhet të kuptojnë dinamikën e konfliktit e të dinë si ta zotërojnë me eftivitet atë cilësi qofshin si palë e përfshirë apo për të zgjidhur atë. Mundësitë për konflikt varen nga papajtueshmëria e synimeve, shkalla në të cilën kemi përdorim të përbashkët të burimeve të kërkuara dhe shkalla e ndërvarësisë së veprimeve.

Konflikti shoqërohet shpesh me një ngarkesë emocionale. Frika e humbjes apo ndryshimit, rrit ngjyrimin emocional në konflikt. Është shumë dimensional, me përmasa që variojnë në të gjitha drejtimet. Konflikti ka pjesëmarrës dhe vëzhgues, disa vëzhgues mund të jenë të interesuar dhe aktivë, të tjerë të painteresuar dhe pasiv. Për pasojë termi konflikt mund të marrë disa kuptime në varësi të rrethanave dhe përfshirjes që ka dikush.

Fillimisht dhe shumë drejtues edhe në ditët e sotme mendojnë dhe besojnë se të gjitha konfliktet, kërcënojnë autoritetin e tyre ndaj duhet të evitohen apo të zgjidheshin mënjëherë. Më vonë dhe shumë drejtues e menaxherë mendojnë se konfliktet janë të paevitueshme dhe duhet mësuar të jetohet me to, e kur është e mundur t'I jepet zgjidhje. Konflikti në varësi të natyrës ka rezultate negative dhe pozitive, ndaj menaxhimi I tyre duhet bërë me kujdes. Departamentet që kanë më pak konflikt priren të mbërthehen nga apatia, mungesa e krijimitarisë, pavendosmëria dhe mos respektimi I afateve. Konflikti I ekzagjeruar mund ta gërryej performancën në organizatë pasi merr energji, mos kënaqje, mungesë bashkëpunimi në punë

Me qëllim që konflikti të menaxhohet efektivisht duhen kuptuar burimet e shumta që favorizojnë, të cilat mund t'I klasifikojmë në dy kategori:

1. **Faktorë strukturorë,** që burojnë nga natyra e organizatës dhe mënyra si është organizuar puna.
2. **Faktorë personal,** që shkaktohen nga ndryshimet mes individëve.

MSC. Marjeta Përlala

MODULI: “MANAXHIM BIZNESI”

Leksioni nr. 17: “Burimet Njerëzore, (departamenti)”.

Në leksionin 17 “Burimet Njerëzore, (departamenti)” do të trajtohet rëndësia e depratamentit të burimeve njerëzore në një biznes.

Struktura e BNJ është grupi formal I caktuar pranë një organizate për të ndihmuar organizimin e njerëzve në mënyrë sa më efektive për të mirën e punonjësve, organizatës dhe shoqërisë.

- Të pasurit e një departamenti BNj varet nga madhësia dhe nga konceptimi I njeriut në punë.
- Bashkëpunimi (partnership) I stafit të BNJ me manaxherët linearë dhe punonjësit është një prirje kryesore në biznesin e sotëm.
- Struktura e BNJ shihet si një funskion kyç që mund të përmirësojë aftësinë e firmës për të konkuruar edhe në organizatat e vogla dhe ato të mëdha.

Roli i biznesit –nëse analizojmën historikun e zhvillimit të biznesit, departamenti I BNJ ka qënë relativisht I përfhsirë pak në problemet dhe objektivat e biznesit.

Menaxherët e BNJ janë marr shpesh me bërjen e planeve të stafit, sigurimin e programeve të trajtimit në punë, apo zhvillimin e programeve të vlerësimit të përformancës.

Me ndryshimin e konceptit të njeriut në organizatë, rikonceptimi si një ndër astetët më të rëndësishme të organizatës, po I përfshinë gjithmonë e më shumë menaxherët e BNJ në organizatë.

Lidhja e BNJ me bzinesin është një rol I ri që duhet të luajë departamenti dhe një nga më të rëndësishmit. Rrjedhimisht kemi përfshirje më të madhe në drejtimin strategjik, afatgjatë, afatshkurtër dhe afatmesëm.

Niveli operacional –nivel afatshkurtër ku departamenti I BNj

bën plane të pajisjes me BNJ, krijon sisteme të monitorimit të përditshëm, administron pagat, llojet e përfitimeve, rregullon sisteme të vlerësimit të përformancës dhe sisteme të kontrollit të përditshëm. Bën trajnime për aftësi specifike pune, përshtat individët me punët specifike planifikon lëvizjet në karrierë.

Niveli manaxherial – nivel afatmesëm, departamenti vlerëson seleksionimin, zhvillon plane marketing për rekrutim, harton plane pesëvjeçarë kompesimi dhe paketa përfitimi. Ngre qëndra vlerësimi, I jep rëndësi zhvillimit në karrierë.

Niveli strategjik – nivel afatgjatë, departamenti përfshihet në vendime më të gjera, përgjithësisht me ato që kan këtë bëjnë me vizionin dhe drejtimin e përgjithshëm të organizatës.

Në realitet programet e BNJ kanë sukses sespe I bëjnë të tillë menaxherët linarë. Në aktivitetet më tradicionale të BNJ si seleksionimi, trajnimi, vlerësimi, shpërblimi, këshillimi, promovimi ndërprerja e largimit nga puna departamenti I BNj I siguron një shërbim menaxherëve linearë. Ai I ndihmon menaxherët linearë edhë nëpërmjet sigurimit të informacionit për intepretimin e legjislacionit për mundësitë e barabarta dhe për standartet e shëndetit dhe sigurisë në punë. Duhet të njihen nevojat e punonjësve, departamenti duhet të jetë sa më afër tyre për identifikimin e tyre. **Klientelizmi është do të shohësh çdonjërin Brenda apo jashtë organizatë si një klientë.**

Megjithëse departamenti i BNJ mund të delegojë shumë nga aktivitetet e tij menaxherëve të linjës, ai është përgjegjës për zbatimin e tyre. Kjo është e mbështetur edhe me legjislacionin për drejtësi në punësim. Një tendencë kryesore në rolin e monitoruesit dhe koordinuesit të zhvillimit është përdorimi I teknologjisë së kompjuterave dhe sistemeve të informacionit për BNJ.

Një rol tjetër I rëndësishëm është ai I sigurimit të teknikave bashkëkohore dhe zhvillimi e eskplorimi I trajtimeve të reja për problemet e personelit. Pasiguria e mjedisit ku organizata operon është e madhe, e sot po kërkohen pikërisht departamente mendjehapur kundrejt risive në përmirësimin e produktivitetit dhe cilësisë së jetës së punonjësve. Kjo zgjidhje kërkohet të justifikohet lehtë dhe të ketë vlerë. Novatorizmi në dinamizmin e sotëm nuk është luks por domosdoshmëri.

Për organizatorët po bëhet gjithnjë e më domosdoshme përshtatja me teknologjitë, strukturat, proceset, kulturat dhe procedurat e reja për t'I bërë ballë konkurrencës. Kërkohet zotësi për të lehtësuar ndryshimin organizativ, për të ruajtur fleksibilitetin aftësinë për tu përshtatur. Departamenti I BNJ duhet t'u paraprijë ndryshimit dhe duhet të sigurojë aftësitë dhe kompetencat e reja në kohën e duhur. Shërben për të qënë model I rolit për ndryshimin dhe aftësinë për t'u përshtatur.

MSC. Marjeta Përlala

MODULI: “MANAXHIM BIZNESI”

Leksioni nr. 18: “Plani Marketing”.

Në leksionin 18 “Plani Marketing” do të trajtohet rëndësia e planit marketing në veprimtarinë e biznesit.

Ndërtimi i një plani marketing

Fusha e performancës:

Kërkesa e tregut (klientët)

Pjesa e tregut

Vlera e klientit

E ardhura për klient

Të ardhurat nga shitjet (monedhë)

Përqindja e fitimit

Fitimi për klient

Kontributi i përgjithshëm (monedhë)

HAPI I: ANALIZA E SITUATËS

Ekzaminimi i plotë i forcave të tregut, pozicionit konkurrues dhe performancës aktuale.

Analiza e situatës në projektimin e një plani marketing përfshinë fuqitë e jashtme dhe të brendshme që formojnë aftësinë tërheqëse të tregut, pozicionit konkurrues dhe performancës aktuale.

Kërkesa e tregut: Tregon nivelin actual dhe të ardhshëm të kërkesës si dhe shitjet e segmentit.

Segmentimi i tregut: Një profil i **çdo** segmenti të shërbyer sipas nevojave dhe ritmit të rritjes së **çdo** segmenti, si dhe të ardhurat dhe marzhi për konsumator.

Analiza e industrisë: Përmbledh forcat e industrisë që formojnë aftësinë tërheqëse të segmentit dhe potencialin për fitim si dhe paraqet indeksin e përgjithshëm të aftësisë tërheqëse të industrisë për **çdo** segment.

Pjesa e tregut dhe mbajtja konsumatore: Paraqet nivelin actual tëpenetrimit në pjesën e tregut dhe identifikon forcat kryesore që formojnë penetrimin në këtë treg.

Ristrukturimi i tregut dhe konkurrenca: Paraqet një përmbledhje të konkurrencës aktuale dhe se si pamja konkur-

ruese e ketij tregu do të strukturohet në 5-vitet e tjera.

Sistemet e kanalit dhe buxhetit marketing: ilustron sistemet e kanalit të përdorura për arritjen e segmenteve të synuara dhe caktimi i buxhetit marketing në lidhje me koston e përvetësimit dhe të mbajtjes së konsumatorëve.

Përformanca e fitimit dhe tregut: Tregon pjesën në treg, mbajtjen konsumatore dhe vlerën e kohës së jetës të çdo segmenti më mirë se shitjet, marzhet dhe fitimet e përftuara aktualisht nga çdo segment.

HAPI II: ANALIZA SWOT

identifimi i fuqive/dobësive dhe shanseve/kërcënimeve me qëllim që të identifikohen çështje kyçe që drejtojnë përformancën.

Analiza SWOT është një përmbledhje e imlikimeve kryesore të strategjisë të pazbuluara nga analiza e situatës.

implikimet strategjike të ndryshme klasifikohensi fuqi dhe dobësi, ose si shanse dhe kërcënime.

Pas analizës SWOT, çështjet më të rëndësishme duhet të identifikohen dhe të përshkruhen në mënyrë të plotë.

Mes implikimeve strategjike që përfshihen në analizën SWOT, ka çështje të rëndësishme që ndikojnë në performancë. Në këto çështje përqëndrohet dhe zhvillimi i strategjive.

HAPI III: PLANI STRATEGJIK I TREGUT

Duke përdorur një analizë të portofolit të tërheqjeve të tregut dhe avantazhet konkurruese, specifikohet një plan strategjik i tregut dhe objektivat e performancës.

Qëllimi kryesor i një plani strategjik për tregun është sigurimi i një drejtimi strategjik nga ku të vendosen objektivat e performancës dhe udhëzimi për zhvillimi e një strategjie të marketingut taktik

Plani strategjik është hapi më i rëndësishëm në procesin e planifikimit marketing, sepse kërkon një ekzaminim me kujdes të kërkesave të tregut dhe përparësive kokurruese të biznesit të bazuara në informacionin e siguruar nga analiza e situatës.

PROBLEMET KRYESORE:

Rritja e konsumatorëve të rinj, kërkon më tepër buxhet marketing deri në depërtimin e plotë në treg.

Fokusi i tregut, **është** i rëndësishëm pasi kemi kapacitet të kufizuar.

Furnizimi dhe çmimi, konkurrenca e reduktuar dhe furnizimi i shkurtër duhet të favorizojnë **çmime** më të larta.

HAPI IV: STRATEGJIA TAKTIKE E MARKETINGUT

Në bazë të një plani marketing strategjik specific, zhvillohet një strategji e marketingut miks për të përmbushur objektivat e performancës së planit strategjik marketing. Zhvillimi i një strategjie marketing për të bërë efektiv planin strategjik të tregut. Strategjia e përgjithshme e marketingut për mbrojtjen, rritjen, reduktimin e përqëndrimit, për prodhimin, hyrjen apo daljen nga një pozicion i tregut është vendosur

nga një plan strategjik i tregut, duhet të zhvillohen strategji taktike marketing më të specifikuara për çdo çështje thelbësore të performancës. Çdo element i strategjisë së marketingut taktik është përgjigje specifike për një çështje thelbësore të performancës që ekziston brenda përkufizimit të një situate marketing.

Strategjitë marketing specifike të zhvilluara do të kenë po aq vlerë sa çështjet thelbësore të performancës.

STRATEGJIA E SEGMENTIT KRYESOR: PËRQËNDRIMI I REDUKTUAR.

1. Sugjerimi i vlerës

2. Strategjia e pozicionit

3. Sistemi i kanalit

4. Objektivat e fitimit.

HAPI V: BUXHETI MARKETING

Një buxhet marketing për strategjinë marketing taktike duhet të zotërojë burime të mjaftueshme të shpërndara në mënyrë që të përmbushë objektivat e performnacës së planit marketing strategjik. Hartimi i një buxheti marketing është një hap kritik në ndërtimin e një plani marketing dhe shumë biznese nuk arrijnë të krijojnë një buxhet marketing adekuat. Procesi i hartimit të një plani marketing deri në këtë fazë nuk paraqet rrezik dhe pasoja ekonomike. Në këtë fazë përcaktohen burimet për çdo plan strategjik të tregut si dhe mbështetja e strategjisë së marketingut taktik me një buxhet marketing, e gjithë kjo duhet të bëhet në mënyrë korrekte, pasi mund të shkoj në dështim.

HAPI VI: KOHËZGJATJA E PERFORMANCËS

Një vlerësim i tregut dhe performancës së fitimit është bërë çdo vit për një planifikim marketing strategjik 3-5 vjeçar. Plani tregon për çdo segment sesi pjesa tregut, të ardhurat nga shitja, marzhet, shpenzimet marketing dhe rentabiliteti do të ndryshojë gjatë planifikimit 5-vjeçar. Kohëzgjatja e performancës paraqet një lidhje të ngushtë midis situatës, strategjisë dhe shpërndarjes së burimeve. Kohëzgjatja e performancës na jep një përshkrim të vlefshëm të saj, prej ku mund të vlerësohet performance aktuale, ndërkohë që përmbushet plani marketing.

HAPI VII: VLERËSIMI I PERFORMANCËS

A janë duke prezantuar nivelet e dëshiruara të përformancës planet marketing strategjik dhe taktik, në lidhje me pjesën e tregut, të ardhurat nga shitjet dhe rentabilitetit. Pas zbatimit të planit marketing, për shkak të ndryshimit të kushteve të tregut mund të shfaqen boshllëqe në përformancë. Adresimi i këtyre boshllëqeve në performancë gjatë kohës që ato shfaqen është një pjesë kritike e procesit të planifikimit marketing. Modifikimi, përshtatja dhe madja dhe braktisja e strategjisë për një segment janë pjesë të procesit të ndërtimit dhe zbatimit të një plani marketing.

MSC. Marjeta Përlala

MODULI: “MANAXHIM BIZNESI”

Leksioni nr. 19: “Njohuri mbi informacionin kontabel të njësisë ekonomike.”

Në leksionin 19 “Njohuri mbi informacionin kontabel të njësisë ekonomike” do të trajtohet rëndësia e informacionit kontabël në njësinë ekonomike.

Informacioni kontabël është tepër i rëndësishëm të dihet të lexohet jo vetëm nga ekonomistët dhe kontabilistët, por nga të gjithë qytetarët, civilët pasi në çdo moment janë grupe interesi, si punonjës; pronar; administrator, drejtues, menaxher;

- Si media;
- Për të ditur të lexohen raportet e vëçanta të shtetit, në lidhje me ne si qytetar;
- Si pjesë e sistemit fiskal; etj.

** Të dish çfarë debitohet (pakësohet) apo kreditohet (shtohet), qoftë edhe në kuletën personale.*

Koncepti bazë i kontabilitetit është i lidhur me konceptin bazë të një njësisë ekonomike funksionale –biznesit. Historia e kontabilitetit e ka zanafillën kur njerëzit mësuan të regjistrojnë aktivitetin ekonomik. Rilindja në art, shkencë, letërsi me patjetër u shoqërua dhe me zhvillmin e kontabilitetit -1494 Luca Paciolo. Kontabiliteti i siguron “sytë” dhe “veshët” drejtimit të njësisë ekonomike. Kontabiliteti karakterizohet si “gjuha e biznesit”, (komunikon me të tretët nëpërmjet informacionit kontabël).

Sistemi i kontabilitetit prodhon:

1. **Të dhënat dhe raportet e drejtimit** – që u shërbejnë drejtimit, menaxherëve t**ë** nivelit të lartë drejtues.
2. **Pasqyrat Financiare** –që u shërbejnë njësisë ekonomike, drejtimit, konsumatorëve, sindikatave, shtetit.
3. **Pasqyrat e taksave** –që u shërbejnë njësisë ekonomike, organeve fiskale.
4. **Raporte speciale** –organeve shtetërore.

- Çdo njësi biznesi duhet të njoh çfarë bën dhe si po ecën financiarisht.

- Kontabiliteti mban llogarinë finaciare të biznesit.

- Identifikon problemet dhe të jep mundësinë që njësia të marr veprime për zgjidhje.

Kontabiliteti është procesi i vrojtimit, i matjes, i vlerësimit, interpretimit dhe komunikimit të informacionit financiar për qëllime të kontrollit financiar dhe marrjen e vendimve efektive të drejtimit ekonomik të njësive ekonomike.

Rëndësia e informacionit kontabël

Të dhënat kontabël shumë të rëndësishme në procesin e marrjes së vendimeve të njësisë ekonomike nga drejtimi. Njohja e situatës finaciare dhe përformancës së njësisë ekonomike nga aksionerët me qëllim që të marrin vendime me investimet në këtë njësi. Shteti ka nevojë për rezultatin e njësisë ekonomike dhe llogaritjen e detyrimeve tatimore ndaj tij. Punonjësit për të ditur sigurimet e tyre, me qëllim përdorimin e tyre. Kontabiliteti i rëndësishëm, pasi siguron informacionin e nevojshëm për të gjitha nivelet e drejtimit ekonomik, për personat fizik dhe juridik që kryejnë një aktivitet të caktuar ekonomik.

Njësia ekonomike.

Njësi ekonomike është çdo grup njerëzish të organizuar në një mënyrë të caktuar për të kryer një detyrë konkrete në kuadrin e tërë aktivitetin ekonomik të shoqërisë duke patur një ekzistencë të pavarur. Koncepti i njësisë ekonomike në kontabilitet përdoret në kuptimin e njësisë të kontabël, e cila është njësia ku fokus janë të gjitha proceset e kontabilitetit, të cilat janë:

- Sipërmarrje private apo publike, shtetërore;
- Biznese të mëdha apo të vogla (të çdo madhësie);
- institucione të ndryshme, bankat, organizatat, etj.

Njësi ekonomike biznesi (që kanë si qëllim final sigurimin e fitimit, si p.sh. bankat, fabrikat, bizneset tregtare etj.)

Njësi jofitimprurëse (që nuk kanë si qëllim final sigurimin e fitimit, por kryerjen e aktiviteteve me karakter të përgjithshëm shoqëror, si p.sh. Spitalet shtetërore, Universitetet shtetërore, shoqatat etj.)

Në kuadrin e sistemit ekonomik, njësia ekonomike nuk vepron si një njësi ekonomike e ndarë, por në lidhje dhe në bashkëveprim të ndërsjellë me njësitë e tjera.

MSC. Marjeta Përlala

MODULI: “MANAXHIM BIZNESI”

Leksioni nr. 20: “Si ti kuptojme raportet vjetore te kompanive, metodologjia, problemet, perberja e raporteve vjetore, menyra e leximit dhe interpretimit.”

Në leksionin 20 “Si ti kuptojme raportet vjetore te kompanive, metodologjia, problemet, perberja e raporteve vjetore, menyra e leximit dhe interpretimit” do të trajtohet rëndësia e analizës financiare nga çdo grup interesi në të cilin mund të jemi të pozicionuar në kompani.

Si e manipulojnë firmat raportimin financiar? Mbivlerësimi i të ardhurave; Përdorimi i një terminologjie konfuze për “fitimin”; Raportohen fitime, ndërkohë që nuk kemi gjenerim flukse arke; I bëjmë të ardhurat e ardhëshme të duken më të mira, duke bërë parreegullsi të ndryshme; Avancojmë ose shtyjmë në kohë të ardhurat dhe shpenzim; Evidentojmë detyrimet jashtë bilancit.

Raporti i auditimit duhet të ofrojën një opinion “të pavaruar” mbi pastërtinë e paraqitjes së pasqyrave financiare.

Ka një sërë rastesh dhe vendimesh gjyqësore kundër firmave audituese. Disa herë ata ofrojnë raporte “të pastra” për problemet e pasqyrave financiare. Firmat kontabile japin konsulta, për firmat që ata auditojnë. Auditët janë punësuar më parë nga firmat që më parë në firma kontabile.

Problemet me analistët janë kur kompanitë janë të mëdha, ku ka konflikt interesash, kur rekomandojnë “të blejnë” në një sërë tregje me problem dhe kur i këshillon publikun ti trajtojë këshillat e analistëve me një farë reserve.

Pasqyrat Financiare të Shoqërive Tregtare Mbështeten në Standartet ndërkombëtare të Kontabilitetit (GAAP). Duhet të pasqyrojnë realitetin ekonomik. Duhet të ofrojnë informacion finaniar që të jetë i kuptueshëm, i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm.

Sektori public rregullon kompanitë që emetojnë letra me vlerë në public.

Raporti vjetor është një material përmbledhës me interes, fotografi me ngjyra e dokumentave kontabile, grafiqe shpjeguese, letër pozitive për aksionerët.

Pasqyrat financiare në një raport vjetor:

1. Pasqyra e të ardhurave (income statement);
2. Pasqyra e gjëndjes financiare (bilanci kontabël);
3. Pasqyra e kapitalit aksioner;
4. Pasqyra e flukseve të arkës.

Raporti financiar përbëhet nga shënime mbi pasqyrat financiare, raporti i auditorëve të pavarur, diskutimet dhe analizat e manaxhimit, përmbledhje e të dhënave kryesore financiare për 5 vjet, të dhëna të tregut.

Raporti i auditorëve: Manaxhimi përgatit pasqyrat financiare; Kontabilistët e pavarur: Auditojnë pasqyrat financiare; Japin opinion mbi pastërtinë dhe vërtetësinë e pasqyrave financiare.

Raporti i pakualifikuar nënvizon: Pasqyrat financiare janë paraqitur në mënyrë të qartë e pastër; Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas SNK dhe SNRF.

Opinioni i pakualifikuar me shpjegime përdoret kur ka ngjarje jo normale të ndodhura, pasiguritë e shkaktuara nga ngjarjet e ardhëshme, në ngjarjet, auditët duhet të përshkruajnë riskun e biznesit dhe çështje që ndikojnë në ekzistencën e firmës.

MSC. Marjeta Përlala

MODULI: “MANAXHIM BIZNESI”

Leksioni nr. 21: “Drejtimi i kompanive shumëkombshe (ndërkombëtare)”

Në leksionin 21 “Drejtimi i kompanive shumëkombshe (ndërkombëtare)”, globalizimi në ditët e sotme ka bërë të domosdoshme që kompanitë për t’I ekzistuar tregut të hedhin vështrimet dhe të zhvillohen edhe pertej tregjeve nacionale ku operojnë, pikërisht këtë do të trajtojmë në këtë leksion.

Globalizimi i referohet tendencave drejt një ekonomie globale më të integruar dhe të ndërvarur; ekonomitë botërore po lëvizin nga sistemet relativisht të izoluara nga kufizimiet/barrierat në tregti dhe investime, pastaj nga distanca, zonat kohore, gjuha, si dhe dallimet në sistemin ligjor e kulturat ... në ekonomi të hapura ku barrierat në tregti dhe investime po zvoglohen; distanca po zvoglohet si rezultat i zhvillimeve në teknologji; kultura po njësohet; dhe ekonomitë nacionale janë duke u shkrirë në ekonomi të ndërvarura dhe integruara, duke krijuar kështu një sistem unik global.

Globalizimi i tregjeve, bashkimi dhe unifikimi i tregjeve nacionale historikisht të ndryshme në një treg të madh global; Dallimet prezente, edhe pse tendencat drejt unifikimit janë evidente, si në shije të konsumatorëve, kanaleve të distribuimit, sistemin e vlerave (kulturat e ndryshme), sistemet në të cilat operojnë bizneset, e veçanërisht sistemin ligjor. Globalizimi i prodhimit, zhvendosja e prodhimit në lokacione me kosto më të ulët dhe kualitet më të lartë të faktorëve të prodhimit; Synim gjithashtu edhe zgjerimi i tregut.

Objektivat janë të identifikohet qëllimi kryesor i Shoqërive Ndërkombëtare dhe konfliktet potenciale me këtë qëllim; Përshkrimi i teirive kyçe që justifikojnë biznesin ndërkombëtar; Shpjegim të metodave më të përhapura për realizimin e biznesit ndërkombëtar.

Korporatat shumëkombëshe janë kompani që merren me prodhimin dhe shitjen e mallrave dhe shërbimeven në më tepër se një vend.

Drejtimi financiar ndërkombëtar është drejtimi financiar i zhvilluar në më tepër se në një ambient kulturor, social, ekonomik apo politik. Ajo lidhe me mundësitë, kostot dhe riskun e operimit ne tregjet botërore për të mira shërbime apo mjete dhe detyrime financiare.

Qëllimi i korporatave shumëkombëshe është maksimizimi i pasurisë së aksionerëve. Në këto shoqëri aksionere ku drejtimi është i ndarë nga manaxhimi ekziston një konflikt në qëllimin e shoqërisë i cili njihet e edhe si problemi i agjencisë.

Kostot e agjencisë janë normalisht më të larta për korporatat ndërkombëtare sesa për firmat vendase, pasi ato janë të përmasave më të mëdha, distancave ku operojnë, kultura të ndryshme menaxhimi të filialeve në vende të ndryshme, vlera e një filiali lundrejt vlerave të filialeve të përgjithshme.

Teoritë e tregtisë ndërkombëtare janë disa si më poshtë:

- Adam Smith (Teoria e Përparësive Absolute)
- David Ricardo (Teoria e Përparësive Krahasuese)
- Teoria Heckscher-Ohlin
- Teoria e bazuar në Ciklin Jetësor të Produktit;
- Teoria e Re e Tregtisë
- Michael Porter: Teoria e Përparësive Konkuruese Nacionale
- Teoritë e investimeve direkte.

Të gjitha këto teori japin shembuj dhe praktika në mirëfunksionimin e këtyre korporatave dhe në drejtimin etyre sa me efektiv dhe eficient.

MSC. Marjeta Përlala

MODULI: “MANAXHIM BIZNESI”

Leksioni nr. 22: “Sistemi i Informacionit Kontabël”

Në leksionin 22 **“Sistemi i Informacionit Kontabël”** do të trajtohet rëndësia e një sistemi kontabël në një biznes.

Parimet bazë të sistemit kontabël Sistemet e informacionit kontabël mbledhin dhe përpunojnë të dhëna nga veprimet dhe ngjarje, I organizojnë ato në forma të nevojshme dhe të dobishme dhe I komunikojnë rezultatet tëk vendimmarrësit. Këto sisteme janë jetësore për vendime efektive si për përdoruesit e jashtëm ashtu dhe për përdoruesit e brendshëm të informacionit. Rëndësia e sistemeve kontabël rritet me zhvillimin dhe me rritje e operacioneve të biznesit, deri në domosdoshmërinë e tyre. Vendimmmarësit kanë nevojë të kenë njohuri bazë sesi fuksionon sistemi i informaionit kontabël. Sistemi i informacioniot kontabël bazohet në pesë parime bazë:

- Kontrolli;
- Rëndësia;
- Pajtueshmëria;
- Fleksibiliteti;
- Kosto-Përfitim.

Parimi i kontrollit Drejtuesit e njësië nuk marrin pjesë gjithnjë dhe në të gjitha hapat e realizimit të aktivitetit të njësisë ekonomike. Për realizimin e biznesit të një njësie ekonomike ata delegojnë autoritetin dhe fuqinë e tyre në nivele më të ulta të drejtimit dhe në persona të tjerë. Rrjedhimisht kjo çon që drejtuesit duhet të kontrollojnë dhe të vëzhgojnë aktivitetet e njësisë ekonomike dhe të kontrollojnë se si janë realizuar detyra që ata kanë caktuar për nivelet më të ulta të organizimit të njësisë ekonomike. Parimi i kontrollit kërkon që një system informacioni kontabël të ketë kontrolle të brendshme. Kontrollet e brendshme përfshijnë metoda dhe procedura që vendosin dhe hartojnë drejtuesit dhe i lejojnë atyre që të kontrollojnë dhe të vëzhgojnë aktivitetet e një-

sisë ekonomike, realizimin e detyrave, kompetencave dhe funksioneve që ata kanë deleguar në nivele më të ulta të drejtimit. Kontrollet e brendshme përfshijnë politikat ndaj operacioneve direkte që kryhen për të realizuar objektivat e përgjithshme, procedurat për të siguruar raporte financiare të besueshme, mjetet për të mbrojtur aktivet e njësisë ekonomike dhe metoda për të vepruar në përputhje me ligjet, rregullimet dhe udhëzimet e brendshme të njësisë.

Parimi i Rëndësisë. Vendimmarrësit kanë nevojë për informacion të rëndësishëm në mënyrë që të marrin vendime. Parimi i rëndësisë kërkon që sistemi i informacionit kontabël të raportojë informacion të përdorshëm, të kuptueshëm, në kohën e duhur dhe përkatës për vendimmarrje efektive. Informacioni kontabël është i projektuar për të "kapur" të dhëna që bëjnë diferencën midis vendimeve, pra që ndikojnë në vendimmarrje. Jo çdo informacion ka nevojë për vendimmarrje. Është e rëndësishme që të gjithë vendimmarrësit të mendohen kur identifikojnë informacion të rëndësishëm për qëllime të paraqitjes.

Parimi i Pajtueshmërisë. Sistemet e informacionit kontabël duhet të jenë në përputhje me qëllimet e njesisë. Parimi i pajtueshmërisë kërkon që sistemi i informacionit kontabël të jetë në përputhje me aktivitetet e njësisë, personelin dhe strukturën. Sistemi kontabël merr parasysh natyrën e llojin e aktivitetit të njësisë ekonomike, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të saj. Sistemi kontabël i një hoteli është i ndryshëm nga sistemi kontabël i një bankë.

Parimi i fleksibilitetit. Sistemet kontabël duhet të jenë në gjendje që t'i përshtaten ndryshimeve që mund të ndodhin në njësi. Parimi i fleksibilitetit kërkon që sistemi i informa-

cionit kontabël të jetë në gjëndje që ti përshtatet ndryshimeve në njësi, në mjedisin e biznesit dhe të nevojave të vendimmarrësve. Përparimet teknologjike, presionet e konkurrencës, preferencat (shijet) konsumatore, rregullat dhe aktivitetet e njësisë ndryshojnë vazhdimisht. Një sistem duhet të projektohet që tu përshtatet këtyre ndryshime duke siguruar një grumbullim të informacionit në nivele të ndryshme, për përdorues të ndryshëm edhe në kushtet e reja të ndryshuara. Kjo siguron mundësinë për uljen e kostos së sigurimit të informacionit.

Parimi Kosto –përfitim. Sistemet e informacionit kontabël duhet të balancojnë kostot dhe përfitimet. Parimi kosto – përfitim kërkon që përfitimet që rrjedhin nga një aktivitet i sitemit të informacionit kontabël të balancojnë kostot e sigurimit të këtij aktiviteti. Kostot dhe përfitimet nga një aktivitet ndikojnë mbi vendimet si të përdoruesit e brendshëm ashtu dhë atyre të jashtëm. Kanë ndikim mbi kostot e llogaritjes së personelit dhe kostove të tjera direkte dhe indirekte. Nëse kostoja tejkalon përfitimet atëherë sistemi i kompjuterizuar bëhët jo eficent dhe i pazbatueshëm ekonomikisht.

Sistemet e informacionit kontabël përbëhen nga njerëzit, regjistrimet, metodat dhe pajisjet. Sistemet janë projektuar për të “kapur” informacion rreth veprimeve të një njësie ekonomike dhe për të siguruar të dhëna (informacion), duke përfshirë këtu raportet financiare, menaxheriale dhe raporte për tatimet. Të gjithë sistemet e informacionit kontabël kanë të njëjtat objektiva, rrjedhimisht ata kanë disa komponentë përbërës bazë. Këto komponentë zbatohen pavarësisht nga fakti nëse sistemi është apo jo i kompjuterizuar.

MSC. Marjeta Përlala

MODULI: “MANAXHIM BIZNESI”

Leksioni nr. 23: “Kontrolli i brendshëm dhe mjetet monetare”

Në leksionin 23 “Kontrolli i brendshëm dhe mjetet monetare” do të trajtohet se rëndësishëm është kontrolli pasi ne jemi grup interesi jo vetëm si punonjës të një biznesi apo organizate por jemi konsumatore të drejtëperdrejtë të tyre.

Kontrolli i brendshëm, qëllimi, parimet, kufizimet e kontrollit të brendshëm. Kontrolli i mjeteve monetare.

Drejtuesit (ose pronarët) e njësive ekonomike të vogla shpesh kontrollojnë të gjitha operacionet. Supervizionojnë punonjësit, marrin pjesë në të gjitha aktivitetet dhe marrin vendimet kryesore. Zakonisht janë këta drejtues që blejnë të gjithë aktivet dhe shërbimet që përdoren në shoqëri. Ata punësojnë dhe drejtojnë punonjësit, negociojnë të gjitha kontratat dhe firmosin çeqet. Këta drejtues –pronarë, janë në dijeni sesi biznesi aktualisht aktivet dhe shërbimet janë paguar.

Për shoqëritë e mëdha është shumë e vështirë të mbahet kjo marrëdhënie kontrolli dhe monitorimi, ndaj është e nevojshme sistemi i kontrollit të brenshëm. Sistemi i kontrollit të brendshëm kontrollon operacionet e brendshme dhe përfshin të gjitha politikat dhe procedurat që përdorin drejtuesit për të:

- Mbrojtur Aktivet;
- Siguruar një kontabilitet të besueshëm dhe realist;
- Promovuar operacione eficiente;
- Nxitur mbështetjen e politikave të njësisë ekonomike.

Nëpërmjet kontrollit të brendshëm sigurohen procedura të tilla të cilat mundësojnë përdorimin e aktiveve për qëllimet e aktivitetit të njësisë ekonomike duke shmangur përdorimin e tyre për nevojat e interest personal te individët e ndryshëm. Duke mundësuar dhe siguruar kontrollin e brendshëm, mundësohet dhe që të dhënat e kontabilitetit të pasqyrojnë realisht ato të situatës financiare dhe të përformancës së njësisë. Kontrolli i brendshëm bën që operacionet të jenë më eficiente. Drejtuesit përqëndrohen së shumti në kontrollin e brendshëm pasi kështu ato monitorojnë përformancën.

Parimet e Kontrollit të Brendshëm

- Përcaktimi i përgjegjësive;
- Mbajtja e saktë e regjistrimve;
- Sigurimi i aktiveve dhe marrëveshjeve kryesore me punonjësit;
- Ndarja e tegjistrimeve nga ruajtja e aktiveve;
- Ndarja e përgjegjësive për veprime që kanë lidhje me njëri-tjetrin;
- Aplikimi i kontrolleve elektronike;
- Kryerja e rishikimeve në mënyrë të rregullt dhe të pavarur.

Një kontroll i brenshëm i përshtatshëm do të thotë që përgjegjësia për çdo detyrë që kryhet në njësinë ekonomike të jetë e përcaktuar qartë dhe të jetë caktuar një person përgjegjës për realizimin e saj. Nëse përgjegjësia nuk përcaktohet, është e vështirë që të vendoset se i kujt është faji apo kush është përgjegjës kur ndodh një problem.

Sistemi i kontrollit të brendshëm parashikon përdorimin e një sërë mjetesh të informatizuara për të lehtësuar kontrollin dhe për të rritur efikasitetin e tij. Librat e arkës, mbrojtësit e çeqeve, kohëshënuesit, numëratorët automatikë dhe skanerët e identifikimit personal janë shembuj të kontrollit që mund të përmirësojnë kontrollim e brendëshëm. Teknologjia informatike shpesh bën që këto mjete të përdoren me eficiencë.

Të gjitha procedurat dhe politikat e kontrollit të brendshëm kanë kufizime.

Elementi njeri ndoshta sjell lindjen e kufizimeve më serioze, të cilët janë potencialisht të ndryshme dhe mund t'i grupojmë si:

- Gabime njerëzorë;

- Mashtrime njerëzore.

Gabimi njerëzor është një faktor që shfaqet sa herë që politikat dhe procedurat e kontrollit të brendshëm zbatohen nga njerëzit.

Gabimi njerëzor mund të ndodh për shkak të neglizhencës, lodhjes, gjykimit jo të drejtë ose konfuzionit.

Mashtrimi njerëzor është synimi i njeriut për të anashkaluar kontrollin e brendshëm për përfitime personale.

Sjellja mashtruese mund të eliminojë shumë kontrolle të brendshme.

Kjo përfshin marrëveshjen e fshehtë për të shkelur parimet e ndarjes së detyrave dhe përgjegjësive.

Elementi njerëzor thekson rëndësinë e vendosjes së një mjedisi të kontrollit të brendshëm për të vënë në dijeni menaxherët në lidhje me politikat dhe procedurat e kontrollit të brendshëm.

MSC. Marjeta Përlala

MODULI: “MANAXHIM BIZNESI”

Leksioni nr. 24: “Drejtimi dhe vendimmarrja”

Në këtë leksion Studenti te njohe dhe te vleresoje domosdoshmerine e perdorimit te metodes se analizes se pikes kufi ne procesin e planifikimit, marketingut dhe kontrollit te zbatimit te planit. Te jete ne gjendje te identifikoje te gjithe burimet e nevojshme te informacionit per perdorimin e metodes se analizes se pikes kufi. Te kuptoje dhe te interpretoje nevojen e vleresimit te te gjithe llojeve te kostove, ne dobi te perdorimit te metodes se analizes se pikes kufi. Te njohe ç›eshte kontributit per njesi, si dhe menyren e llogaritjes se tij per aktivitetet e ndryshme ne ndermarrje. Te pervetesoje teknikat e llogaritjes se prodhimit ne piken kufi, te ardhurat ne piken kufi, çmimin ne piken kufi, pjesen e tregut ne piken kufi, etj. Te dije se si te llogarise sasine e nevojshme te prodhimit ne inventar per ndermarrjen.

Konceptet që do të shqyrtohen informacion, kosto, kosto eksplicite, kosto implicite, kosto te kontrollueshme, kosto te pa kontrollueshme, kosto fikse, kosto variable, kontribut, analize e pikes kufi, kosto inventari, etj.

Perdorime te metodes se analizes se pikes kufi: Per planifikimin veprimtarise se ndermarrjeve; Per kontrollin e veprimtarise se ndermarrjeve; Per planifikimin e shpenzimeve te marketingut te ndermarrjeve; Per percaktimin e niveleve te prodhimit, cmimit, kostos, te ardhurave, etj.; Per mire menaxhimin kapacitetiteve prodhuese, dhe qe nenkupton se c’fare jemi ne gjendje te prodhojme dhe me c’lloj tregu do te perballemi ne te ardhmen.

Qëllimi i leksionit është te shpiegojë teorikisht dhe praktikisht perdorimet e metodes se analizes se pikes kufi ne drejtimin e prodhimit (planifikimit, kontrollit & marketingut).

Per te perdorur analizen e pikes kufi ne marrjen e vendimeve ekonomike rracionale, eshte i nevojshem nje sistem i caktuar informacioni. Informacioni kontabël perben burimin baze te ketij informacioni pasi ai cili pasqyron teresine e operacionet financiare te ndermarrjes. Buxhetet e aktiviteteve perbejne nje tjeter burim te rendesishem informacioni. Informacionet e tjera nga burime shtetore dhe private jane po ashtu burime mjaft te rendesishme.

Per te perdorur drejte metoden e analizes se pikes kufi, menaxheret duhet te konsiderojne Menyren se si kostot do t'ju përgjigjen ndryshimeve në aktivitetet e biznesit. Faktit qe ka kosto mbi të cilat menaxhimi ushtron pak kontroll, apo kosto te tjera mbi te cilat ai mund te ushtroje me shumë kontroll. Faktit qe ka kosto të cilat ndryshojnë në përpjestim të drejtë me ndryshimet në volumin e biznesit. Faktit qe ka kosto te tjera ta cilat mund të ndryshojnë me aktivitetin e biznesi, por me një rritëm të parregullt. Menyren se si duhet ndertuar sistemi i informaconit, ne menyre qe ai te jete ne gjendje për të sinjalizuar ne kohe menaxhimin ne rastet kur nje aktivitet i caktuar i ndermarjes po operon jashtë standarteve të përcaktuara. Menyren se si do te perdoret informacioni mbi kosto për te realizuar funksionet e planifikimit, kontrollit dhe te marketingut.

Per te perdorur me sukses metoden e analizes se pikes kufi ne duhet te kemi nje perfytyrim te qarte per kostot e akivitetit te firmes. Per kete, ne analizën menaxheriale është e domosdoshme qe paraprakisht të kuptojmë konceptet baze që kane të bëjnë me kostot.

MSC. Marjeta Përlala

MODULI: “MANAXHIM BIZNESI”

Leksioni nr. 25: “Drejtimi dhe vendimmarrja”

Në këtë leksion studenti te jete ne gjendje te evidentoje cilesite qe dallojne menaxherin “perfaqesues” te çdo shkolle drejtimi, te njoh karakteristikat me dalluese te te gjithe shkollave te drejtimi dhe mbi kete baze te jete ne gjendje qe te percaktoje se ç’far shkolle duhet t’i referohet ai ne procesin e drejtimit te firmes, te njohe ne detaje dallimet ne mes teoris X dhe asaj Y, si dhe te vleresoje sjelljen e tij ne procesin e drejtimit, te njohe faktoret social-ekonomik qe kane diktuar nevojen e lindjes se shkences se menaxhimit, te njihet nga afer roli i menaxherit ne veprimtarine e firmes dhe ne kete kontekst, sfidat shtese qe duhet te perballojne menaxheret e firmave te agrobiznesit, te njihen dimensionet e drejtimit dhe mbi kete baze te percaktohet sjellja e studentit ne rolin e nje menaxheri, te njohe lidhjet dhe ndervaresite ne mes funksioneve te drejtimit, te aftesohet ne procesin e vendimarrjes permes interpretimit te situatave konkrete.

Konceptet që do të përftohen janë: Metode Drejtimi, Shkolle Drejtimi, Shkolle Autokratike, Autoritare, Burokratike, Laissez Faire, Demokratike, Pjesmarrese, Teori X, Teori Y. Menaxher, Drejtim, Planifikim, Planifikim operativ, Planifikim taktik, Planifikim strategjik, Organizim, Kontroll, Dimension drejtimi, etj.

Eshte e nevojshme te konsiderojme se metodat e drejtimit, kuptimi dhe interpretimi i tyre, jane prone e çdo njeriu. Nisur nga ky fakt, mund te thuhet se menaxheri i afte ndodhet gjithnje brenda nesh. eshtja eshte: Si mund te zbulohet ai?

Shkolla (Autokratike) Çfare cilesish mbart menaxheri i kesaj shkolle? Merr vet vendime. I ben ato publike perpara se t’i kontrolloje me te tjeret. Insiston qe te gjitha vendimet te meren nga zyra e tij, pamvarsisht se ato mund te jene shume apo pak te rendesishme. I vetem, ai ruan kontroll te plote mbi organizaten e tij. Insiston qe ai te permbush rolin kryesor ne te gjithe procesin e marrjes se vendimeve. Ndersa autokrati do t’ja imponoje vendimin organizates, perfaqesuesi i kesaj shkolle, perpiqet t’ia shes vendimin e tij organizates.

Shkolla (Burokratike)Çfare cilesish mbart menaxheri i kesaj shkolle? Prezanton idete dhe fton qe t'i behen pyetje perpara se te merren vendimet. Zoteron nje nivel te caktuar te perdorimit te fuqise absolute. Ai prezantohet si nje krijese per organizaten, dhe qe ekziston per t'i sherbyer asaj. Perdorur organizaten per te plotesuar objektivat e tij, si dhe per mbrojtjen e tij personale, ne se eshte e nevojshme.

Shkolla (Lases faire) Çfarë cilesish mbart menaxheri i kesaj shkolle? Brenda ketij koncepti gjendet nje kombinim i organizates, grupit dhe punetoreve. Perfaqeson nje balance te caktuar ndermjet shkolles se dominimit te drejtuesit dhe shkolles se dominimit te punetorit.

Frederik Tayjlor. Eshte teoricieni i pare i madh ne fushen e drejtimit. Puna e tij ndikoi ne formimin e disiplinave baze ne fushen e inxhinierise industriale. Tayjlor njihet si babai i drejtimit shkencor, si rezultat i percaktimit te kater parimeve kryesore te menaxhimit

Me drejtim do te nënkuptojmë realizim detyrash nëpërmjet njerëzve. Per kete arsye, në çdo organizatë ka një person apo një grup personash që prognozojne dhe ndjekin realizimin e detyrave, te cilet ne terminollogjine ekonomike quhen menaxherë. Funksionet qe ato kryejne menaxheret fillojne nga ai i presidentit e deri tek ai i përgjegjësit te njesive me te vogla te organizimit te firmes. Menaxheret mbajnë përgjegjësi për projektimin, ndjekjen dhe permbushjen me sukses të objektivave te paracaktuara.

Nje menaxheri i mire, nder te tjera duhet te karakterizohet nga tre aftesi themelore:

- Aftesi per marrjen e vendimeve
- Afesi per punuar me eproret dhe vartesit (pra te punoje ne ekip)
- Aftesi per percaktimin e synimeve dhe objektivave.

MSC. Marjeta Përlala

EUROPEAN CENTER FOR MINORITY ISSUES KOSOVO

ALBANIAN INSTITUTE FOR INTERNATIONAL STUDIES

AKADEMIA RINORE E SIPËRMARRJES DIGJITALE

Trajnier: Msc. Marjeta Përlala

This project is funded by the European Union

Moduli “Manaxhim Biznesi”

Leksion: “SI TI KUPTOJME RAPORTET VJETORE TE KOMPANIVE, METODOLOGJIA, PROBLEMET, PERBERJA E RAPORTEVE VJETORE, MENYRA E LEXIMIT DHE INTERPRETIMIT”

Si e manipulojnë firmat raportimin financiar

- Mbivlerësimi i të ardhurave
- Përdorimi i një terminologjie konfuze për “fitimin”
- Raportohen fitime, ndërkohë që nuk kemi gjenerim flukse arke
- I bëjmë të ardhurat e ardhëshme të duken më të mira, duke bërë parreegullsi të ndryshme
- Avancojmë ose shtyjmë në kohë të ardhurat dhe shpenzim
- Evidentojmë detyrimet jashtë bilancit

Problemet me auditorët

Raporti i auditimit duhet të ofrojë:

- Një opinion “ të pavaruar” mbi pastërtinë e paraqitjes së pasqyrave financiare

Por. . .a janë vërtet të pavarur audituesit?

- Ka një sërë rastesh dhe vendimesh gjyqësore kundër firmave audituese
- Disa herë ata ofrojnë raporte “të pastra” për problemet e pasqyrave financiare
- Firmat kontabile japin konsulta, për firmat që ata auditojnë
- Auditët janë punësuar më parë nga firmat që më parë në firma kontabile

Problemet me analistët

- Kompanitë janë të mëdha
- Konflikti i interesave
- Recomandojnë “të blejmë” në një sërë tregje me probleme
- SEC i këshillon publikun ti trajtojë këshillat e analistëve me një farë rezerve

Cfarë kërkoni ju nëse mbështeteni në pasqyrat financiare për vendimet e rëndësishme financiare?

- Të kuptuarin drejtë të treguesve kryesorë të raporteve financiare
- Aftësia të vlerësojë drejt informacionin

Pasqyrat Financiare të Shoqërive Tregtare

- Mbështeten në Standartet ndërkombëtare të Kontabilitetit (GAAP)
- Duhet të pasqyrojnë realitetin ekonomik
- Duhet të ofrojnë informacion finaniar që të jetë:
  - I kuptueshëm
  - I mjaftueshëm dhe i përshtatshëm

Autoritetet kryesore përgjegjëse për zbatimin e SNK(GAAP)

- Komisioni i letrave me vlerë (SEC)
- Bordi i standarteve të kontabilitetit financiar (Në rastin e SHBA, FASB)
- Parlamenti

SEC (Sektori publik)

- Rregullon kompanitë që emetojnë letra me vlerë në publik

KLV kërkon:

- Plan e të dhëna të plota për ofertën e letrave me vlerë
- Raportet vjetore (10-K)
- Raportet tremujore (10-Q)
- Raporte të tjera (8-K)
- Pasqyra të përafërta apo të sakta

FASB (Sektori privat)

- Cështjet
  - Pasqyrat sipas SNK
  - Interpretimet

KLV

- Mbështeten në SNK (FASB) për shumicën e rregullave kontabile që vendosen.

Ç’ është raporti vjetor?

- Një material përmbledhës me interes
- Fotografi me ngjyra e dokumentave kontabile
- Grafiqe shpjeguese
- Letër pozitive për aksionerët

Pasqyrat financiare në një raport vjetor:

1. Pasqyra e të ardhurave (income statement)
2. Pasqyra e gjëndjes financiare (bilanci kontabël)
3. Pasqyra e kapitalit aksioner
4. Pasqyra e flukseve të arkës

Përbërja e raportit vjetor (Vazhdim):

- Shënime mbi pasqyrat financiare
- Raporti i auditorëve të pavarur
- Diskutimet dhe analizat e manaxhimit
- Përmbledhje e të dhënave kryesore financiare për 5 vjet
- Të dhëna të tregut

Çfarë kërkohet aktualisht?

- Pasqyrat financiare
- Shënimet shpjeguese
- Raporti i auditit
- Diskutimet e manaxherëve
- Treguesit kryesore për 5 vjet
- Të dhëna të tregut

Materiale të tjera?

- Shqetësimet e paraqitura nga manaxherët
- Shqetësimet e kompanisë në raport me të tjerët

Cfarë të reja kërkojmë për raporte të reja financiare

- Raportet mbi marrëdhëniet e reagimet e publikut mbi të dhënat financiare
- Kur këto janë të larta apo po rriten…

Le të shohim!

Pasqyra e të ardhurave (Income Statement)

- Rezulton nga operacionet e firmës
- Të ardhurat dhe shpenzimet
- Burimi I të ardhurave dhe shpenzimeve të tjera, jashtëveprimtarisë operative
- Fitimi ose humbja neto
- Fitimi ose humbja neto për aksion

Pasqyra e gjendjes financiare (Bilanci kontabël)

- Paraqet:
  - Aktivet
  - Burimet
  - Kapitali aksionar

Pasqyra e kapitalit aksionar

- Pasqyron tepricën (gjendjen)në fillim dhe mbarim të periudhës të llogarive të kapitalit aksionar

Pasqyra e flukseve të arkës

- Ofron informacion mbi flukset hyrëse dhe dalëse të arkës

Shënimet në pasqyrat financiare

- Ndjekin të katër pasqyrat financiare
- Duhet të lexohen patjetër që të kuptojmë drejtë pasqyrat financiare

Shënimet e pasqyrave financiare…

Shënimi 1: Përmbledhje mbi politikat kontabile

Shenime të tjera

- Ofrojnë detaje e hollësi kontabile
- Informacion tjetër

Shëmbuj mbi shënimet e pasqyrave financiare

Shënimi 1: Politikat kontabile më të ndjeshme

Shënimi 2: Llogaritë e arkëtueshme

Shënimi 3: Inventaret

Shënimi 4: Pronat

Shëmbuj mbi shënimet e pasqyrave financiare

Shënimi 5: Llogaritë e pagueshme dhe huamarrja afatshkurtër

Shënimi 6: Huamarrja afatgjatë

Shënimi 7: Burime të tjera afatgjatë

Shënimi 8: Angazhime e kontigjenca

Shëmbuj mbi shënimet e pasqyrave financiare

Shënimi 9: Instrumentat financiarë

Shënimi 10: Tatimi mbi të ardhurat

Shënimi 11: Programet e ristrukturimit dhe të uljes së kostos

Shënimi 12: Planet e pensioneve

Shëmbuj mbi shënimet e pasqyrave financiare

Shënimi 13: Përfitimet pas daljes në pension jo të natyrës pensionare

Shënimi 14: Opsionet e aksioneve dhe planet e kompensimit

Shënimi 15: Shkrirjet dhe bashkimi I kapitaleve

Shënimi 16: Shitja e aktiveve

Shëmbuj mbi shënimet e pasqyrave financiare

Shënimi 17: Informacioni segmentuar

Shënimi 18: Ngjarjet e mëtejshme, të mëvonshme

Shënimi 19: Të dhëna mbi shitjet tremujore dhe të ardhurat tremujore

Të paaudituara

Raporti i auditorëve

- Manaxhimi përgatit pasqyrat financiare
- Kontabilistët e pavarur:
  - Auditojnë pasqyrat financiare
  - Japin opinion mbi pastërtinë dhe vërtetësinë e pasqyrave financiare

Raporti i pakualifikuar nënvizon:

- Pasqyrat financiare janë paraqitur në mënyrë të qartë e pastër
- Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas SNK dhe SNRF

Opinioni i pakualifikuar me shpjegime

Përdoret kur ka:

- Ngjarje jo normale të ndodhura
- Pasiguritë e shkaktuara nga ngjarjet e ardhëshme
- Në ngjarjet, auditët duhet të përshkruajnë:
  - Riskun e biznesit
  - Cështje që ndikojnë në ekzistencën e firmës

Raporti i kualifikuar

Përdoret kur kanë ndodhur:

- Shmangie nga SNK(GAAP)
- Kufizimet e tjera

Seksioni i diskutimeve të manaxherëve dhe analizat e bëra

- Mjet i rëndësishëm në vlerësimin e firmës
- Përmban informacione e opinione të brëndshme për të ardhmen e firmës dhe ecurinë e saj
- Paraqet informacion cilësor që nuk gjëndet në të dhënat financiare

Seksioni i diskutimeve të manaxherëve dhe analizave të bëra trajton:

- Trendet e favorshme
- Trendet e pafavorshme
- Ngjarjet me peshë në pasiguritë ne fushën e:
  - Likuiditetit
  - Burimeve të kapitalit
  - Resultateve të operacioneve

Kufizimet në Seksionin e diskutimeve të manaxherëve dhe analizave të bëra:

- Janë thjesht opinione të manaxherëve për gjendjen e kompanisë

Përmbledhje e të dhënave 5 vjeçare dhe të dhëna të tregut

Ofrojnë një pamje të përgjithshme të performancës së firmës

- Kushtet financiare

Shumë tregues kyç nuk paraqiten në përmbledhje

Të dhëna mbi çmimet e tregut

- Pamje fotografike e performancës së aksioneve të zakonshme për një periudhë dy vjeçare
- Paraqet cmimin tremujor më të lartë dhe më të ulët të aksioneve të zakonshme

Problemet e raportit vjetor të Enron 1996

- Të ardhurat u rritën më shpejt se arkëtimet
- Rënie e të ardhurave operative
- Flukse arke negative
- Trendi jonormal në flukset hyrëse nga operacionet
- Numuri dhe volumi i angazhimeve dhe kufizimeve
- Paqartësia në informacionin e papërshtatshëm

Flamurët e alarmit:

- Ndryshimi i auditëve
- Shmangia apo largimi nga opinioni pakualifikuar në raportin e auditëve me pranimin ose një gjuhë shpjeguese
- Penalizime nga SEC kundër ffirmës apo auditëve

Flamurët e alarmit. . .

- Rritja e raporteve të alarmit tek të dhënat financiare
- Shtyrja për llogaritë e dobishme që nuk përputhen me llogaritë e arkëtueshmee
- Të ardhurat dhe arkëtimet:
  - Rritja me raporte të ndryshme
  - Lëvizja në drejtim të kundërt

Flamurët e alarmit. .. . .

- Flukse negative ose të paqëna nga operacionet
- Arkëtime dhe flukse hyrëse arke nga operacionet lëvizin në
  - Raporte të ndryshme
  - Drejtime të ndryshme

Flamurët e alarmit :

- Një sërë shtyrjesh e kufizimesh
- Kompania e vë emrin e saj në arenën e sportit

EUROPEAN CENTER FOR MINORITY ISSUES KOSOVO

ALBANIAN INSTITUTE FOR INTERNATIONAL STUDIES

AKADEMIA RINORE E SIPËRMARRJES DIGJITALE

Trajnier: Msc. Marjeta Përlala

This project is funded by the European Union

Moduli “Manaxhim Biznesi”

Leksion: “Sistemi i Informacionit Kontabël”

Tema 6: “Sistemi i Informacionit Kontabwl”

1. Parimet bazë të ndërtimit të sistemit;
2. Përbërësit e sistemit kontabël;
3. Kontabiliteti dhe informatizimi i tij.

1. Parimet bazë të sistemit kontabël

- Sistemet e informacionit kontabël mbledhin dhe përpunojnë të dhëna nga veprimet dhe ngjarje, I organizojnë ato në forma të nevojshme dhe të dobishme dhe I komunikojnë rezultatet tëk vendimmarrësit.

- Këto sisteme janë jetësore për vendime efektive si për përdoruesit e jashtëm ashtu dhe për përdoruesit e brendshëm të informacionit.

- Rëndësia e sistemeve kontabël rritet me zhvillimin dhe me rritje e operacioneve të biznesit, deri në domosdoshmërinë e tyre.

- Vendimmmarësit kanë nevojë të kenë njohuri bazë sesi fuksionon sistemi i informaionit kontabël.

- Sistemi i informacioniot kontabël bazohet në pesë parime bazë:

- Kontrolli;
- Rëndësia;
- Pajtueshmëria;
- Fleksibiliteti;
- Kosto-Përfitim.

1.1 Parimi i kontrollit

- Drejtuesit e njësië nuk marrin pjesë gjithnjë dhe në të gjitha hapat e realizimit të aktivitetit të njësisë ekonomike.
- Për realizimin e biznesit të një njësie ekonomike ata delegojnë autoritetin dhe fuqinë e tyre në nivele më të ulta të drejtimit dhe në persona të tjerë.
- Rrjedhimisht kjo çon që drejtuesit duhet të kontrollojnë dhe të vëzhgojnë aktivitetet e njësisë ekonomike dhe të kontrollojnë se si janë realizuar detyra që ata kanë caktuar për nivelet më të ulta të organizimit të njësisë ekonomike.

- Parimi i kontrollit kërkon që një system informacioni kontabël të ketë kontrolle të brendshme.
- Kontrollet e brendshme përfshijnë metoda dhe procedura që vendosin dhe hartojnë drejtuesit dhe i lejojnë atyre që të kontrollojnë dhe të vëzhgojnë aktivitetet e njësisë ekonomike, realizimin e detyrave, kompetencave dhe funksioneve që ata kanë deleguar në nivele më të ulta të drejtimit.
- Kontrollet e brendshme përfshijnë politikat ndaj operacioneve direkte që kryhen për të realizuar objektivat e përgjithshme, procedurat për të siguruar raporte financiare të besueshme, mjetet për të mbrojtur aktivet e njësisë ekonomike dhe metoda për të vepruar në përputhje me ligjet, rregullimet dhe udhëzimet e brendshme të njësisë.

1.2 Parimi i Rëndësisë

- Vendimmarrësit kanë nevojë për informacion të rëndësishëm në mënyrë që të marrin vendime.
- Parimi i rëndësisë kërkon që sistemi i informacionit kontabël të raportojë informacion të përdorshëm, të kuptueshëm, në kohën e duhur dhe përkatës për vendimmarrje efektive.
- Informacioni kontabël është i projektuar për të “kapur” të dhëna që bëjnë diferencën midis vendimeve, pra që ndikojnë në vendimmarrje.
- Jo çdo informacion ka nevojë për vendimmarrje.
- Është e rëndësishme që të gjithë vendimmarrësit të mendohen kur identifikojnë informacion të rëndësishëm për qëllime të paraqitjes.

1.3 Parimi i Pajtueshmërisë

- Sistemet e informacionit kontabël duhet të jenë në përputhje me qëllimet e njesisë.
- Parimi i pajtueshmërisë kërkon që sistemi i informacionit kontabël të jetë në përputhje me aktivitetet e njësisë, personelin dhe strukturën.
- Sistemi kontabël merr parasysh natyrën e llojin e aktivitetit të njësisë ekonomike, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të saj.
- Sistemi kontabël i një hoteli është i ndryshëm nga sistemi kontabël i një bankë.

- Kjo sepse dhe nevojat për informacion dhe kontroll janë të ndryshme për këto njësi e përcaktohen nga natyra e ndryshme e aktivitet e këtyrë njësive ekonomike.

- Sistemi kontabël duhet të adaptohet me karakteristikat unike të njësië.

- Sistemi kontabël duhet të jetë në harmoni dhe të orientohet nga objektivat e njësisë, nga strukturat e organizimit të saj, nga shtrirja gjeografike dhe nga nevoja e vendimmarjes të drejtuesve të saj.

1.4 Parimi i fleksibilitetit

- Sistemet kontabël duhet të jenë në gjendje që t'i përshtaten ndryshimeve që mund të ndodhin në njësi.
- Parimi i fleksibilitetit kërkon që sistemi i informacionit kontabël të jetë në gjëndje që ti përshtatet ndryshimeve në njësi, në mjedisin e biznesit dhe të nevojave të vendimmarrësve.
- Përparimet teknologjike, presionet e konkurrencës, preferencat (shijet) konsumatore, rregullat dhe aktivitetet e njësisë ndryshojnë vazhdimisht.
- Një system duhet të projektohet që tu përshtatet këtyre ndryshime duke siguruar një grumbullim të informacionit në nivele të ndryshme, për përdorues të ndryshëm edhe në kushtet e reja të ndryshuara.
- Kjo siguron mundësinë për uljen e kostos së sigurimit të informacionit.

1.5 Parimi Kosto -përfitim

- Sistemet e informacionit kontabël duhet të balancojnë kostot dhe përfitimet.
- Parimi kosto –përfitim kërkon që përfitimet që rrjedhin nga një aktivitet i sitemit të informacionit kontabël të balancojnë kostot e sigurimit të këtij aktiviteti.
- Kostot dhe përfitimet nga një aktivitet ndikojnë mbi vendimet si të përdoruesit e brendshëm ashtu dhë atyre të jashtëm.
- Kanë ndikim mbi kostot e llogaritjes së personelit dhe kostove të tjera direkte dhe indirekte.
- Nëse kostoja tejkalon përfitimet atëherë sistemi i kompjuterizuar bëhët jo eficent dhe i pazbatueshëm ekonomikisht.

2. Përbërësit e sistemeve të kontabilitetit

- Sistemet e informacionit kontabël përbëhen nga njerëzit, regjistrimet, metodat dhe pajisjet.
- Sistemet janë projektuar për të “kapur” informacion rreth veprimeve të një njësie ekonomike dhe për të siguruar të dhëna (informacion), duke përfshirë këtu raportet financiare, menaxheriale dhe raporte për tatimet.
- Të gjithë sistemet e informacionit kontabël kanë të njëjtat objektiva, rrjedhimisht ata kanë disa komponentë përbërës bazë.
- Këto komponentë zbatohen pavarësisht nga fakti nëse sistemi është apo jo i kompjuterizuar.

- Komponentët përëbërës të sistemeve të kompjuterizuara zakonisht sigurojnë më tepër saktësi, shpejtësi, eficencë dhe leverdishmëri.
- Pesë janë komponentët bazë të një sistemi informacioni kontabël:

- Dokumentët bazë;
- Mjetet që sigurojnë futjen e të dhënave;
- Përpunuesit e informacionit;
- Ruatja (depozitimi) i informacionit;
- Mjetet që sigurojnë komunikimin (nxjerrjen) e informacionit.

2.1 Dokumentet bazë

- Dokumentet bazë japin apo sigurojnë informacionin bazë që përpunohet nga sistemi i kontabilitetit.
- Dokumentat bazë janë: ekstraktet bankare, çeçet, mandate arkëtimet, apo pagesat, faturat e blerjes apo të shitjes.
- Dokumentat bazë mund të jenë në forma dhe përmbajtje të ndryshme, në letër apo në forma elektronike, ose kalimi direct nga një system kontabël në një tjetër.
- Pavarësisht nga forma që ata kanë, duhet të kenë një përmbajtje informacioni të domosdoshëm në lidhje me datën e veprimit, të shumës së veprimit, të natyrës dhe llojit të veprimit, emrat dhe firmat përgjegjëse.

- Dokumenti bazë i saktë dhe i kujdesshëm është thelbësor për sistemet e informacionit kontabël.
- Futja e një sistemi jo të saktë ose jo të plotë dëmton shumë besueshmërinë dhë rëndësinë e sistemit të informacionit.
- Shmangia e gabimeve hyrëse dhe dalëse, si dhe njihen në kontabilitet.
- Një system kontabël i organizuar mirë parashikon edhe kontrollin në lidhje me rregullsinë e përmbajtjes dhe formës së dokumentave si dhe të lidhjes më saktësinë matematikore të tyre, para se ato të përpunohen në fazat e tjera të sistemit kontabël, pra para se të regjistrohen në ditar.

2.2 Mjetet që sigurojnë futjen e të dhënave

- Mjetet që përdoren për të future të dhënat e dokumenteve në procesin e përpunimit të tyre në sistemin kontabël, janë një element shumë i rëndësishëm.
- Mjetet që sigurojnë futjen e të dhënave marrin informacion nga dokumentet bazë dhe sigurojnë trasferimin e tyre në elementin tjetër të sistemit atë të përpunimit.
- Këto mjete shpesh përfshijnë transformim në të dhëna, duke u bazuar në dokumentet bazë dhe duke I përshtat me sistemin, kjo duhet të jetë e saktë, pasi çon në deformim të tyre.

- *Psh rasti i një supermarket, arkëtarja skanon barcode dhe nëpërmjet këti nr disa shifror futet dokumenti bazë në system dhe niset përpunimi i tij.*
- Sistemet e informacionit kontabël të kompjuterizuara rrisin saktësinë nëpërmjet metodave të duhura në futjen e të dhënave, si dhe rrisin shpejtësinë e përpunimit të informacionit kontabël.
- Jo çdo kush ka akses në futjen e informacionit kontabël, ato janë persona të autorizuar.
- Kontrollet rrisin besueshmërinë e një sistemi.
- Ata lejojnë kapjen e një burimi informacioni të gabuar.

2.3 Përpunimi I informacionit

- Përpunimi i të dhënave është një element përbërës i sistemit kontabël i cili interpreton dhe përmbledh informacion, i cili përdoret në analizat dhe raportimet.
- Sistemi bazuar në parimet e regjistrimit të dyfisht, në regjistrimin kronologjik dhe sistematik të të dhënave, si dhe në nevojat e përdoruesve për informacion në forma të caktuara, përpunon të dhënat e marra nga dokumentat bazë.
- Gjykimi professional zë një pjesë të rëndësishme në sistemet kontabël.

- Përpunimi i të dhënave dhe ndërtimi i PF nga sistemet kontabël realizohet bazuar në parimet kontabël.
- Përpunimi i informacionit kontabël përbëhet nga librat kontabël të tillë si ditarët, libri I madh, librat ndihmës, fletët e punës, bilancet vërtetues si dhe procedurat e mbartjes të regjistrimeve kronologjike në regjistrimet sistematike.
- Këto të dhëna ndihmojnë në trasformimin e të dhënave të papërpunuara në informacion të përdorshëm për nevoja të përdoruesve të jashtëm dhe të brendshëm.

- Përpunimi i informacionit mund të realizohet në mënyrë manual, dhe në këtë rast elementët përbërës të tij do të jenë në formën e librave kontabël në përmbajtje letër.
- Në ditët e sotme gjithmonë e më shumë ky përpunim po zëvëndësohet me kompjuter.
- Përdorimi i kompjuterave dhe programeve informatike kontabël duke respektuar parimet e përgjithshme kontabël, siguron efikasitet, produktivitet dhe shpejtësi në përpunimin e informacionit kontabël dhe eficiencë.
- Përpunimi i informatizuar ka bërë që kontabilistët të përqëndrohen më shumë në analizat dhe në interpretimin e të dhënave të nevojshme për drejtim.

2.4 Ruatja e informacionit

- Ruatja e informacionit është një përbërës shumë I rëndësishëm në sistemin kontabël, pasi duhet të ruhen me qëllim nënshtrimit të përpunimit në një moment të dytë.
- Të dhënat pasi futen përpunohen, ruhen për t'u përdorur në analizat ose raportet e ardhshme.
- Këto të dhëna mund të përdoren nga personat që merren me përgatitjen e raporteve periodike financiare si dhe për analiza të tjera.
- Ky component është i projektuar që të ndihmojë në përgatitjen e raporteve të brendshme Gjithashtu audituesit përdorin oikërisht këtë bazë të dhënash kur auditojnë PF

- Të dhënat mund të ruhen edhe në formate letre (librash, dokumentash, raporte të printuara etj.), mund të bëhet nëpërmjet programeve elektronike apo sistemeve online.
- Jo çdo kush ka të drejtë aksesimi apo hyrje, pasi kërkon asistencë ose autorizim.
- Një system efikas kontabiliteti parashikon dhe përcaktimin e niveleve të të drejtave për hyrjen në sistemet e informacionit kontabël

2.5 Mjetet që sigurojnë komunikimin e informacionit.

- Informacioni kontabël i përpunuar duhet t'u komunikohet përdoruesve të brendshëm e të jashtëm për ta përdorur në marrjen e vendimeve ekonomike.
- Mjetet që sigurojnë komunikimin e informacionit nga sistemi kontabël tek përdoruesit janë një përbërës shumë i rëndësishëm i sistemit.
- Këto mjete bëjnë të mundur që informacioni të shikohet, të printohet dhe të përdoret nga përdoruesit.
- Mjetet më të zakonshme janë printerat dhe ekranet, por mund të jenë dhe telefonat, faqet e web-it etj.
- Format e komunikimit të informacionit janë të shumta, si më lart.

3. Kontabiliteti dhe informatizimi i tij.

- Teknologjia po luan një rol shumë të rëndësishëm në sistemin e informacionit kontabël, duke patur një ndikim të madh në përpunimin e të dhënave dhe në mënyrën sesi funsionon përpunimi I të dhënave dhe nxierrja e rezultateve kontabël.
- Teknologjia e kopjuterit në kontabilitet mund të grupohet në dy kategori të mëdha:

1. Hardëare është pjesa fizike e pajisjeve.
2. Softëare janë progaremt që drejtojnë operacionet hardëare-it.

Përpunimi i të dhënave në kontabilitet

- Sistemet kontabël ndryshojnë nga mënyra e futjes së të dhënave dhe përpunimit të tyre.
- Përpunim online
- Përpunim periodik.

Faleminderit!

This project is funded by the European Union

Moduli “Manaxhim Biznesi”

Komunikimi në Biznes dhe kuptimi i Etikës
”

Shkolla “Kolin GjokA” Lezhë, më 12 janar 2020

PËRMBAJTJA E LEKSIONIT

- **KUPTIMI I ETIKëS**
- Situatat Etike
- Etika si një çështje e komunikimit
- **INFLUENCAT Në ETIKëN PERSONALE**
- Njerëzit
- Kultura
- Filozofia
- Ligji
- Besimi Fetar
- **KOMUNIKIMI DHE ÇëSHTJET ETIKE**
- Çështjet ligjore

1. KUPTIMI I ETIKëS

Marrja e vendimeve etike është relativisht më e thjeshtë kur njihen të gjitha faktet, ngjarjet dhe situatat.

- Kur informacioni mungon apo kur ka çështje të ndryshme, rezulton të këmi vështirësi dhe deri në konflikt.

Si duhet të reagojmë ndaj paqartësive dhe të marrim vednimin e duhur etik kur çështjet janë të paqarta?

- **Etika ka të bëjë me marrjen e vendimeve të duhura dhe shmangien e atyre të gabuara.**
- **Parimet etike trajtojnë problem të ndreshmërisë, shërbimit, cilësisë, integritetit, sensibilitetit, finesës dhe dinjitetit.**

Situtat etike

- **Secili nga ne çdo ditë merr vendime, duke ndërtuar në ndërgjegjën tonë konceptet e të drejtës dhe të gabuarës duke formuar disa parime të caktuara të etikës sonë.**

***Shembull*:** *"Gjatë një interviste pune, pyeteni se pse ju duhet të merreni në punë dhe jo një kandidat tjetër, që e supozojmë që është shoku, miku juaj I ngushtë. Nëse keni disa informacione negative mbi këtë person çfarë do të bënit, do t'ia tregonit apo jo intervistuesit?"*

Një përgjigje e shpejtë do të ishte që ne gjithmonë zgjedhim vendimin e duhur në përputhje me moralin shoqëror, çfarë do të thotë se një përgjigjje mund të ishte: “Miqësia duhet të triumfojë mbi përfitimin personal”.

- është vendim I drejtë dhe moral?
- Në çfarë rrethanash do të vepronit ndryshe?
- Pse mos ia tregojmë intervistuesit informacionin në lidhje me kanditatin konkurrentë?
- Bota sot bazohet në konkurrencë?!

Vënia e ngjarjeve etike në një kontekst më të gjerë do të ndryshonte mënyrën në të cilën ne e përceptojmë këtë ngjarje.

Një përgjigjje e prerë nuk është gjithmonë e saktë.

Etika e procesit të vendimmarrjes varet në një masë të madhe nga vetë situata

- Manaxheri, apo çdo profesionist ballafaqohet me dilemma të ngjashme etike.
- Manaxheri, apo çdo profesionist është mirë të testohen për atë çfarë ata gjykojnë si të drejtë dhe çfarë si të gabuar.
- Të marrësh dhe të japësh mendime në raste të ndryshme konkrete do të ishte frytdhënëse.

Shembull: *"Administratori I një hoteli kohët e fundit ka blerë 20 arka me verë nga një furnitor I ri. Furnitori, pa dijeninë e administratorit I shpie një arkë vere falas në shtëpinë e këtij të fundit. Administratori vendos ta mbajë arkën e dhënë për konsum personal pasi ai mendon se marrja e kësaj arke nuk ka influencuar në vlerën e blerjes së 20 arkave të hotelit."*

mbajtur arkën e verës?

- Shumë prej nesh mund të mendoj se është e gabuar mbajtja e arkës së verës nga ana e tij.

- Shumë prej nesh mund të mendoj se nuk është e gabuar pasi ai marrjen e arkës së verës e mendon si një dhuratë, nga ana e furnitorit.

Vendimi është etik?

Etika si një çështje e komunikimit

Ne nuk jemi qënie njerëzore që kemi një eksperiencë shpirtërore, por jemi qënie shpirtërore që kemi një eksperiencë njerëzore.

- Ne identifikohemi në sytë e të tjerëve me mënyrën se si sillemi, duke ua komunikuar vlerat dhe besimet tona me anë të sjelljeve verbale dhe jo-verbale.

- Për të maksimizuar vlerat e një organizate, njësie ekonomike punonjësit duhet të sillen në mënyrë te tillë që të promovojnë ndershmëri dhe drejtësi.

- Drejtuesit, menaxherët, pronarët janë ata që caktojnë një linjë etike për biznesin.
- Veprimet e tyre tregojnë vlerat e njësisë ekonomike, nëse ajo është e korruptuar, e manipuluar dhe pre e devijimeve të ndryshme, apo është e hapur e ndershme dhe gatshme për të pranuar dështimet e mundshme.
- Menaxherët, drejtuesit, pronarët duhet të shprehen dhe jo të heshtin, kur diçka nuk shkon mirë në kompani.
- Duhet të jenë ata përsonat që influencojnë të tjerët për të përcaktuar linjën e etikës që duhet ndjekur
- Shpeshherë ne mund të dimë se çfarë është është e mirë apo çfarë është e keqe, por na mungon forca e brendshme ose ndenja kolektive që roforcon veprimin në mënyrë etike.
- Vëzhgimi I njerëzve të tjerë që bëjnë veprime të duhura etike shërbejnë si frymëzues edhe për ne, duke na motivuar të bëjmë të njëjtën gjë.

2. INFLUENCAT Në ETIKëN PERSONALE

- Secili nga ne merr vendime etike.

- A keni mbajtur të fshehtë ndonjë informacion prej dikujt I cili mund të kishte interes apo të përfitonte nga ky lloj informacioni?
- A keni kthyer ndonjëherë diçka të gjetur?
- A keni qëndruar të heshtur kur dinit faktet e ndodhura po fshiheshin?

Po ne vetë jemi aq etikë sa mendojmë?

Etika personale është e "shkallur" nga 5 influence kryesore.

1. Njerëz me influencë në jetën tonë (familja, miq, shok të ngushtë, ose njerëz që merren si model).
2. Normat kulturore.
3. Pozicioni filozofik.
4. Ligjet locale dhe shtetëore që qeverisin sjelljen individuale.
5. Pikëpamjet fetare.

Familja luan një rol shumë të rëndësishëm në formimin e etikës personale.

Kur jemi të vegjël dhe rinj, mësuesit (në mënyrë të veçantë) mund të vendosin themelet tona etike.

2. KULTURA

Disa nga vlerat etike mësohen nga kultura. (P.sh. Nëse jemi rritur në një qytet të madh kemi vlera të ndryshme nga dikush që është rritur në fshat, ose kur kjo ka ndodhur në shtete të ndryshme).

Me kalimin e kohës vlerat e çdo culture pasurohen.

3. FILOZOFIA

Teoritë e ndryshme filozofike janë marrë për një kohë të gjatë me çështjet e etikës dhe të moralit.

“Etika përshkruese” dhe “Etika detyruese” janë emërtimet për dy tippet më kryesore të kërkimit filozofik.

çfarë është morale dhe e drejtë dhe njëkohësisht se çfarë kontribuon pozitivisht në eksperiencën njerëzore.

Pikëpamjet detyruese filozofike kryesore që ndikojnë mbi biznesin dhe vendimet personale janë:

1. Teologjia - këndvështrim moral që tenton të përkufizojë sjelljet në përputhje me dëshirën e Zotit.
2. Deontologjia - është studimi I detyrimeve apo obligimeve morale.
3. Teleplogjia - është studimi I shenjave të formimit të natyrës.
4. Utilitarianizmi - është një formë teologjie që argumenton se një veprim është moralisht I drejtë në qoftë se ai maksimizon dobishmërinë.

Ligji prezanton minimumin e standarteve të sjelljes.

Shumë njerëz ee shikojnë etikën nga një këndvështrim ligjor, si psh respektimi I etikës është respektimi I ligjit.

Ndoshta ligji përfaqëson një standart minimal të sjelljes etike, psh kodet e etikës për profesione si kontabilist, jurist, mjek kërkojnë standarte sjellje që e kapërcejnë ligjin.

Por kur konsideratapër ligjin është jo e drejtë, pra jemi joetik?

5. BESIMI FETAR

Besimet në mbarë botën janë baza e sjelljes etike.

“Shenjtëria” e jetës është një karakteristikë thelbësore e shumë besimeve në botë.

3. KOMUNIKIMI DHE ÇëSHTJET ETIKE

- Komunikimi etik në arenën e biznesit është një sfidë që duhet përballuar në një sërë nivelesh.
- Çështjet ligjore kanë një ndikimi shumë të madh si tek individi ashtu edhe tek organizata që I mbart.
- Sfidat organizative përfshijnë ndërtimin e një culture productive në një kompani me të punësuar që kanë formim, vlera dhe besime të ndryshme.
- Në të gjitha këto sfida, sistemi personal I vlerave do të ndikojë në sjelljen e vendim-marrësit po aq sa dhe të personave që e rrethojnë.

Çështjet ligjore

- Çështjet ligjore siç janë akuzat, fyerjet dhe sekretet janë shqetësuese për çdo organizatë.
- Shumë individë dhe kompani hidhen në gjyq për fyerje ndaj pesonit, sa çështje ligjore, ato janë dhe çështje etike, pasi akuzat qofshin formale apo verbale kanë shkelur parimet e ndeshmërisë, respektit dhe dinjitetit njerëzor.
- Ligjet në fuqi mbrojnë “intimitetin”, pra të drejtën private, por në ditët e sotme jemi të ekspozuar nga informacioni I shumtë dhe ai mund të vihet në rrezik, duke shkelur privatësinë.
- Diskriminimi dhe ngacmimet janë çështje të tjera me pasoja etike dhe ligjore.
- Kopjimi, duke përfshirë shkeljen e të drejtës së autorit, prodhimet fallco etj., është çështje etike me pasoja ligjore.
- Të dreitat e autorit (copyrights)

PROBLEME KRITIKE Në KOMUNIKIMIN ETIK

- Trajtimi në mënyrë etike i një çështjeje kërkon kohë, mendim dhe përgatitje.

- Për një menaxher gjatë procesit të komunikimit është I rëndësishëm fokusimi në tre fusha kryesore:

1. Mesashet personale të shkruara dhe të folura.
2. Mesazhet ndërkulturore.
3. Mesazhet reklamuese.

ETIKA DHE PëRGJEGJëSIA ORGANIZATIVE

- **Vendet e punës përmbajnë shpeshherë shumëllojshmërinë e vlerave etike. Çdo individ sjell qëndrimet e tij mbi atë se çfarë quhet etikë.**
- Sjelljet organizative dominojnë jetën dhe qëndrimet tona.
- Organizatat janë më të pushtetshme sesa individët e thjeshtë.
- Kanë në dorë mjete monetare që u japing mundësinë të kenë pushtet për të influencuar tek të tjerët.
- Paraj mund të “blejë” si pushtetin ashtu dhe ndikimin, por gjithsesi kompania duhet të mendohet mirë mbi masën në të cilën ato e përdorin paranë për të “blerë” ndikimin e të tjerëve”

Konfliktimi i etikës: Kriteret formale në raport me ato informale

- A duhet menaxherët të përcaktojnë vlerat e një organizate dhe t'ia përcjellin më pas ato të niveleve më të ulëta dhe individëve të veçantë si percjellin strategjitë dhe politikat?
- Apo këto përkufizime të vlerave dhe etikës duhet të lindin nga radhët e punonjësve?
- A është etika me efektive kur ajo imponohet?
- Apo, vlerat e organizatës janë më të forta kur krojohen "gjiri" I organizatës, nivelet e mesme dhe të ulëta të saj, duke reflektuar në këtë mënyrë atë që beson realisht shumica e punonjësve?

1. Mesazhet publike.
2. Manualet për punonjësit dhe formulimet e politikave.
3. Formulimi i misionit të organizatës dhe kodet etike.

RRUGëT JOFORMALE:

Një organizatë krijon strukturat e saj etike në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet punëtorëve, manaxherëve, si dhe mënyrave të saj organizative.

1. Kultura dhe vlerat janë importuar në çdo organizatë nëpërmjet pjesëmarrjes.
2. Organizatat në vetvete janë instrumente sociale që prodhojnë sistemin e tyre të vlerave.
3. Veprimet e menaxherëve, drejtuesve dhe pronarëve mund të ndihmojnë në formimin e kulturës dhe të vlerave të kompanisë.

FALEMINDERIT!

This project is funded by the European Union

Moduli “Manaxhim Biznesi”

Parimet e Komunikimit Efektiv – “Shtatë C-të e komunikimit”

Shkolla “Kolin GjokA” Lezhë, më 25 janar 2020

PËRMBAJTJA E LEKSIONIT

1. TËRËSIA
2. KONÇIZITETI
3. KONSIDERATA
4. KONKRETËSIA
5. QARTËSIA
6. KORTEZIA
7. KORREKTËSIA

Të gjitha “C-të” mund të aplikohen si për komunikimin e folur edhe për atë të shkruar.

- Për të ndërtuar mesazhe efektive të shkruara dhe gojore, duhet që të aplikohen parime komunikimi të caktuara.
- 7 “C-të” e komunikimit janë tërësia, konçiziteti, konsiderata, konkretësia, qartësia, kortezia, korrektësia.
- Këto parime janë të aplikueshme për të gjitha format e komunikimit, që nga fjalët apo fjalitë e thjeshta dhe deri tek dokumentet apo prezantimet e kompletuara.
- Në mjaft këndvështrime këto parime edhe mund të mbivendosen, pasi bazohen në një preokupim të përbashkët për audiencën, pavarësisht nëse kjo audiencë është e përbërë nga dëgjues apo lexues.

1. TËRËSIA

Marrësi i mesazhit, qoftë degjues apo lexues, dëshiron informacion të plotë për pyetjet e tij.

- Mesazhi i një biznesi është i kompletuar ku ai përmabn të gjitha faktet që i nevojiten dëgjuesit ose lexuesit për reagimin që dëshirohet.
- Tërësia ofron përfitime të shumta:

- mesazhete plota pritet të japing rezultatet e dëshiruara pa shepnzimin e mesazheve shtese;
- Mund të bëjnë një punë më të kënaqshme për të ndërtuar vullnetin e mirë, duke ngjallur dhe interes;
- Komunikimet që mund të duken të parendësishëm mund të jenë tepër të rëndësishëm nëse informacioni që ato mbartin është I plotë

- Të jesh terësor dhënë të kemi parasysh:

1. **Sigurimin e të gjithë informacionit të domosdoshëm;**

Përgjigjet ndaj 5 “ë-ve” (ëho –kush; ëhat –çfarë; ëhen –kur; ëhere –ku; ëhy –Pse.)

2. **Përgjigjje ndaj të gjithë pyetjeve të bëra;**

Shikohen me kujdes pyetjet, disa prej tyre mund të kuptohen me vështirësi, lokalizoni dhe pastaj jepini përgjigjje të sakta.

3. **Dhënia e diçka suplementare kur ajo dëshirohet.**

Përdor logjikën në dhënien e materialit shtesë, në rastet kur mesazhi I dërguesit është I paplotë.

2. KONCIZITETI

- Konciziteti është të shprehurit e asaj çfarë duhet thënë me sa më pak fjalë të jetë e mundur dhe pa sakrifikuar cilësitë e tjera të “C-ve”.
- Konciziteti është një kusht për komunikim efektiv në biznes, pasi kursen kohën dhe shpenzimet si për dërguesin edhe për marrësin.
- Konciziteti kontribuon në eliminimin e fjalëve të panevojshme, por tregon dhe respect për marrësin dukë mos I “tejngopur” jetën e tyre profesionale me informacione të panevojshme.

Duhet të:

- Eliminohen shprehjet fjalë –shumë;
- Përfshihen vetëm materialet që lidhen me çështjen;
- Shmangen përsëritjet e panevojshme.

të përdoren fjalë të thjeshta në vend të frazave të ngarkuara;

- Të fokusohesh fort tek qëllimi I mesazhit;
- Të eliminohen fjalët pa lidhje dhe fjalitë e tejzgjatura;
- Të mos përsëritet që në fillim ajo çfarë është për t'u thënë më parë nga marrësi I informacionit;
- Të shmangen prezantimet e gjata, shpjegimet e panevojshme.

- Të perdoren terma të shkurtra, pas përdorimit më parë të termave të gjatë.
- Përdorimi I përemrave ose inicialeve në vend të emrave të gjatë.
- është e nevojshme që "të spastrohen" të gjitha përsëritjet e frazave dhe fjalive të panevojshme.

3. KONSIDERATA

- Konsiderata është të përgatitesh çdo mesazh duke patur parasysh marrësin e mesazhit.
- Gjuha dhe përmbajtja e mesazhit duhet adaptura sipas nevojave të marrësit gjatë periudhës që mesazhi është duke u kompletuar.
- Tre mënyra specifike për të treguar konsideratë janë:

1. Fokusimi tek shprehja “JU” në vend të shprehjes “UNë” dhe “NE”;
2. Theksimi i përfitimeve dhe interesave që mund të fitojë audience, të cilat duhet të zënë një pjesë të rëndësishme të mesazhit;
3. Theksimi I fakteve positive dhe të kenaqshme, pra përdorimi I termave pozitiv rrit efektivitetin e mesazhit, rrjedhimisht lexuesit do të reagojnë në një mënyrë të përshtatshme.

4. KONKRETËSIA

Keqkuptimi I fjalëve ka sjellë treagjedi si në luftë, edhe në paqe, në situate biznesi ose jo.

- Të komunikosh konkretisht do të thotë që të jesh specific, përcaktuar dhe I gjallë, në vend që të jesh I vakët dhe I përgjithshëm.
- Të përdoren fjalë direkte në vend të fjalëve me nënkuptim.
- Të përdoren fakte, shifra konkrete.
- Mesazhet konkrete janë më të sakta dhë dinamike.
- Gjatë diskutimit foljet duhet të bëhen vepruese dhe active.

Gjithmonë kur kryefjala “vepron”, ndjehet më tepër jetë dhe gjallëri.

Foljet vepruese ndihmojnë që t'i bëjnë fjalitë më:

- Specifike. Shprehja “Drejtori vendosi” është më eksplicite se sa “Një vednim u mor”.
- Personale (direkte). Shprehja “Ju do të vini re…” është më personale dhe specifike se “Do të vihet re…”.
- Konçize. Përsorja kërkon më shumë fjalë në ndërtimin e fjalisë.
- Emfatike (theksuese). Foljet përsore shpesh e “ngathtë-sojnë” veprimin.

- Përdorni më tepër foljet dhe jo emrat.

Foljet shtyjnë mendimin, ato lëvizin idetë, duke zëvëndësuar veprimin e ngadalshëm të emrave.

- Të zgjidhen fjalë të gjalla dhe imazh –ndërtuese.
- Gjuha konkrete shpesh nxit përgjigjje sensore tek njerëzit duke thërritur një ose më shumë prej pesë shqisave.
- Analogjitë ose krahasimet mund të kthjelltësojnë një ide të turbullt, ose të bëjnë një ide akoma dhe më të gjallë.
- Përdorimi i shprehjeve figurative me kujdes, pasi mund të bëjnë mesazhin jo të qartë dhe konkret.

Puna e saj me grupet ishte ekzemplare.

Ajo mund të quhej "Shpirti I grupi".

5. QARTËSIA

- Qëllimi i qartësisë është “nxjerrja” e kuptimit nga mendja e një individi dhe “transferimi” I tij në mendjen e lexuesit (e bërë kjo sa më saktësisht).

- **Për të qënë sa më qartë nevojitet:**

1. Të zgjidhen fjalët sa më preçize, konkrete dhe të njohura.

(Kur ka paqartësi është mirë që të perdoren më shumë fjalë të njohura. Audienca do t’I kuptojë ato më mirë.)

2. Të ndërtohen fjali dhe paragrafë sa më efektive.

(Vini më shpesh idetë kryesore në fillim të një fjalie.)

- Të zgjidhen fjalë sa më konkrete, preçize, të sakta e të thjeshta që të jetë e mundur.

- Të zgjidhen fjalë që kanë sens të lartë përshtatshmërie për lexuesin.

- Të zgjidhen fjalë të njohura dhe që nuk janë “pompoze” dhe të ekzagjeruara.

- Të limitohen gjatësitë mesatare të fjalive me 15-17 fjalë.

- Të mos futen me shumë se sa një ide kryesore në një fjali.

6. KORTEZIA

Njohja e audiencës lejon që të përdoren shprehjet e përshtatshme të politesës. Për këtë arsye informohuni mirë mbi marrësin e mesazhit.

- Kortezia, apo politesa e vërtetë përfshinë jo vetëm marrjen në konsideratë të mendimeve të të tjerëve por dhe ndjenjat e tyre.
- Kortezia karakterizohet nga një qëndrim respektues ndaj të tjerëve.
- Kortezia është edukatë që rritet nga respekti dhe preokupacioni për të tjerët.
- Në çdo shkrim apo komunikim duhet të manifestohen sjelljet me

KONCEPTET BAZË TË KORTEZISË

- Pyetni vetën nëse komunikimi juaj ka gjithmonë në “qëndrim-ju”.

- Nëse keni dyshime për taktin që përdorni në deklaratat tuaja, a e keni diskutuar këtë me miq? Opinioni I të tjerëve mund të të ndryshojë mënyrën tuaj të të shprehurit.

- Tregohuni të kujdesshëm në përdorimin e humorit gjatë komunikimeve tuaja. Edhe këtu këshillat e dikujt mund të jenë të vlefshme.

- Tregohu I kujdesshëm gjatë të shprehurit. Kjo nënkupton respektimin e moshës, racës, besimit dhe origjinave etnike.

7. KORREKTËSIA

- **Në thelb të korrektësisë është përdorimi I rregullave gramatikore, I shenjave të pikësimit dhe të mënyrave të shqiptimit.**

- **Një mesazh mund të jetë gramatikisht dhe mekanikisht perfekt, por përsëri mund të jetë diskriminues duke sjellë për shembull largimin e një klienti nga një biznes.**

KONCEPTET BAZË TË KORREKTËSISË

- Përdorni nivelin e përshtatshëm të gjuhës në komunikimet tuaja formale apo informale.

- Mbani parasysh se gjuha informale është në shumë raste me e përdorshme se ajo formale.

- Kontrolloni shpesh paraqitjen korrekte të fakteve, shifrave apo fjalëve. Kjo mund të realizohet duke kërkuar këshillat e kolegëve pasleximit nga ana e tyre të materialeve.

- Kontrolloni etiken dhe estetikën gjatë përgatitjes së materialeve.

FALEMINDERIT!

This project is funded by the European Union

Moduli “Manaxhim Biznesi”


Burimet Njerëzore (Departamenti)

Shkolla “Kolin GjokA” Lezhë, më 15 shkurt 2020

Departamenti i Burimeve Njerëzore

Struktura e BNJ është grupi formal I caktuar pranë një organizate për të ndihmuar organizimin e njerëzve në mënyrë sa më efektive për të mirën e punonjësve, organizatës dhe shoqërisë.

- Të pasurit e një departamenti BNj varet nga madhësia dhe nga konceptimi I njeriut në punë.
- Bashkëpunimi (partnership) I stafit të BNJ me manaxherët linearë dhe punonjësit është një prirje kryesore në biznesin e sotëm.
- Struktura e BNJ shihet si një funskion kyç që mund të përmirësojë aftësinë e firmës për të konkuruar edhe në organizatat e vogla dhe ato të mëdha.


Drejtori i Departamentit të Burimeve Njerëzore
Përgjegjës i Sektorit të BNJ
Sektori i Çështjeve Ligjore
Specialistë
Specialistë
Specialistë
Specialistë

Rolet e Departamentit BNJ

Roli i biznesit –nëse analizojmën historikun e zhvillimit të biznesit, departamenti I BNJ ka qënë relativisht I përfhsirë pak në problemet dhe objektivat e biznesit.

- Menaxherët e BNJ janë marr shpesh me bërjen e planeve të stafit, sigurimin e programeve të trajtimit në punë, apo zhvillimin e programeve të vlerësimit të përformancës.
- Me ndryshimin e konceptit të njeriut në organizatë, rikonceptimi si një ndër astetët më të rëndësishme të organizatës, po I përfshinë gjithmonë e më shumë menaxherët e BNJ në organizatë.
- Lidhja e BNJ me bzinesin është një rol I ri që duhet të luajë departamenti dhe një nga më të rëndësishmit. Rrjedhimisht kemi përfshirje më të madhe në drejtimin strategjik, afatgjatë, afatshkurtër dhe afatmesëm.

Roli i Binznesit i BNJ në tre nivele

- **Niveli operacional** –nivel afatshkurtër ku departamenti I BNj bën plane të pajisjes me BNJ, krijon sisteme të monitorimit të përditshëm, administron pagat, llojet e përfitimeve, rregullon sisteme të vlerësimit të përformancës dhe sisteme të kontrollit të përditshëm. Bën trajnime për aftësi specifike pune, përshtat individët me punët specifike planifikon lëvizjet në karrierë.
- **Niveli manaxherial** –nivel afatmesëm, departamenti vlerëson seleksionimin, zhvillon plane marketing për rekrutim, harton plane pesëvjeçarë kompesimi dhe paketa përfitimi. Ngre qëndra vlerësimi, I jep rëndësi zhvillimit në karrierë.
- **Niveli strategjik** –nivel afatgjatë, departamenti përfshihet në vendime më të gjera, përgjithësisht me ato që kan ëtë bëjnë me vizionin dhe drejtimin e përgjithshëm të organizatës.

Roli i mbështetësit (ndihmësit)

- Në realitet programet e BNJ kanë sukses sespe I bëjnë të tillë menaxherët linarë.
- Në aktivitetet më tradicionale të BNJ si seleksionimi, trajnimi, vlerësimi, shpërblimi, këshillimi, promovimi ndërprerja e largimit nga puna departamenti I BNj I siguron një shërbim menaxherëve linearë.
- Ai I ndihmon menaxherët linearë edhë nëpërmjet sigurimit të informacionit për intepretimin e legjislacionit për mundësitë e barabarta dhe për standartet e shëndetit dhe sigurisë në punë.
- Duhet të njihen nevojat e punonjësve, departamenti duhet të jetë sa më afër tyre për identifikimin e tyre.

Klientelizmi është do të shohësh çdonjërin Brenda apo jashtë organizatë si një klientë.

Roli Monitorues

- Megjithëse departamenti i BNJ mund të delegojë shumë nga aktivitetet e tij menaxherëve të linjës, ai është përgjegjës për zbatimin e tyre.

- Kjo është e mbështetur edhe me legjislacionin për drejtësi në punësim.

- Një tendencë kryesore në rolin e monitoruesit dhe koordinuesit të zhvillimit është përdorimi I teknologjisë së kompjuterave dhe sistemeve të informacionit për BNJ.

Roli i novatorit

- Një rol tjetër I rëndësishëm është ai I sigurimit të teknikave bashkëkohore dhe zhvillimi e eskplorimi I trajtimeve të reja për problemet e personelit.

- Pasiguria e mjedisit ku organizata operon është e madhe, e sot po kërkohen pikërisht departamente mendjehapur kundrejt risive në përmirësimin e produktivitetit dhe cilësisë së jetës së punonjësve.

- Kjo zgjidhje kërkohet të justifikohet lehtë dhe të ketë vlerë.

- Novatorizmi në dinamizmin e sotëm nuk është luks por domosdoshmëri.

Roli i Përshtatësit

- Për organizatorët po bëhet gjithnjë e më domosdoshme përshtatja me teknologjitë, strukturat, proceset, kulturat dhe procedurat e reja për t'I bërë ballë konkurrencës.

- Kërkohet zotësi për të lehtësuar ndryshimin organizativ, për të ruajtur fleksibilitetin aftësinë për tu përshtatur.

- Departamenti I BNJ duhet t'u paraprijë ndryshimit dhe duhet të sigurojë aftësitë dhe kompetencat e reja në kohën e duhur.

- Shërben për të qënë model I rolit për ndryshimin dhe aftësinë për t'u përshtatur.

Rolet për liderin e BNJ

- Njeri i biznesit.
- Krijues i ndryshimit në harmoni me biznesin.
- Konsulent për organizatën, partner për menaxhimin linear.
- Planifikues i strategjive/biznesit.
- Menaxher i talentit.

Praktika Shqiptare për stafin e BNJ

- Pjesa më e madhe e organizatave në vednin tonë janë të vogla dhe të mesme, nuk mungojnë koorporatat.
- Në organizatat e vogla rolet e BNj përgjithësisht I luan pronarët menaxherë ose menaxherët linearë.
- Edhe në organizatat e mëdha, mungesa e njohurive, eksperiencës apo mungesa e ndërgjegjësimit, ndikon në zhvillimin e mjaftueshëm të departamentit të BNJ.
- Në sektorin public, kërkesat për kandidatët e BNj, theksohet të kenë mbaruar shkenca shoqerore, ose ekonomike. (Menaxhimi I Burimeve Njerëzore është fushë studimi e mirëfilltë).
- Kemi një aplikim deri diku të cungët të politikave dhe strategjive të BNJ në mjedisin shqiptar.

Programi për menaxhimin e BNJ

Një program për MBNJ cakton objektivat, politikat, procedurat dhe buxhetin e përshtatshëm për realizimin e funksioneve të BNJ.

1. **Objektivat** - përcaktohen nga objektivat e përgjithshme të organizatës. Këto po reflektohen gjithnjë e më shumë edhe në përgjgjësinë sociale të organizatës.
2. **Politikat** - të lidhura ngushtë me objektivat e BNJ, politikat shërbejnë për veprimet e nevojshme për arritjen e këtyre objektivave.

Nevoja për politika - politikat e zhvilluar me kujdes janë jetësore për MBNJ, sepse punonjësit janë të ndjeshëm ndaj çdiference në trajtimin e tyre në krahasim me të tjerët.

Formulimi i politikave – formulimi I politikave BNJ duhet të bëhët nga një grup ku bashkëpunojnë menaxherët, mbikqyrsit, anëtarët e BNj

Shpallja e politikave të shkruara - organizatat mund t'i bëjnë me autoritare politikat e BNj duke I shkruar ato. Për të forcuar efektivitetin e tyre këto shpallje që mund të jenë në formë manualësh politikash, duhet të përfshijnë dhe arsyen pse duhen këto politika.

3. Procedurat - shërbejnë për të implementuar politikat nëpërmjet përshkrimit në mënyrë kronologjike të hapave që duhen ndjekur për këtë.

Procedurat e BNJ ashtu si dhe politikat e BNJ duhet të trajtohen si mjete për arritjen e qëllimit dhe jo si qëllime në vetvete.

Kur organizatat janë burokratike, ky manual procedurash është më I detajuar, për të ndihmuar të gjitha palët e interesit.

Procedurat duhet të rishikohen në mënyrë periodike, të modifikohen, të përshtaten me kushtet e ndryshueshme të vazhdueshme të mjedisit ku organizata operon.

Politikat dhe procedurat janë tipike për organizatat e mesme dhe të mëdha.

Në organizatat e vogla MBNJ shpesh bëhët në mënyrë informale

FALEMINDERIT!

This project is funded by the European Union

Moduli “Manaxhim Biznesi”

PLANI MARKETING

Shkolla “Kolin GjokA” Lezhë, më 23 shkurt 2020

Ndërtimi i një plani marketing

Fusha e performancës:

Kërkesa e tregut (klientët)

Pjesa e tregut

Vlera e klientit

E ardhura për klient

Të ardhurat nga shitjet (monedhë)

Përqindja e fitimit

Fitimi për klient

Kontributi i përgjithshëm (monedhë)

Ekzaminimi i plotë i forcave të tregut, pozicionit konkurrues dhe performancës aktuale.

Analiza e situatës në projektimin e një plani marketing përfshinë fuqitë e jashtme dhe të brendshme që formojnë aftësinë tërheqëse të tregut, pozicionit konkurrues dhe performancës aktuale.

Kërkesa e tregut: Tregon nivelin actual dhe të ardhshëm të kërkesës si dhe shitjet e segmentit.

Segmentimi i tregut: Një profil i çdo segmenti të shërbyer sipas nevojave dhe ritmit të rritjes së çdo segmenti, si dhe të ardhurat dhe marzhi për konsumator.

Analiza e industrisë: Përmbledh forcat e industrisë që formojnë aftësinë tërheqëse të segmentit dhe potencialin për fitim si dhe paraqet indeksin e përgjithshëm të aftësisë tërheqëse të industrisë për çdo segment.

Pjesa e tregut dhe mbajtja konsumatorëve: Paraqet nivelin aktual të tëpenetrimit në pjesën e tregut dhe identifikon forcat kryesore që formojnë penetrimin në këtë treg.

Ristrukturimi i tregut dhe konkurrenca: Paraqet një përmbledhje të konkurrencës aktuale dhe se si pamja konkurruese e ketij tregu do të strukturohet në 5-vitet e tjera.

Sistemet e kanalit dhe buxhetit marketing: ilustron sistemet e kanalit të përdorura për arritjen e segmenteve të synuara dhe caktimi i buxhetit marketing në lidhje me koston e përvetësimit dhe të mbajtjes së konsumatorëve.

Përformanca e fitimit dhe tregut: Tregon pjesën në treg, mbajtjen konsumatore dhe vlerën e kohës së jetës të çdo segmenti më mirë se shitjet, marzhet dhe fitimet e përftuara aktualisht nga çdo segment.

HAPI II: ANALIZA SëOT


identifimi i fuqive/dobësive dhe shanseve/kërcënimeve me qëllim që të identifikohen çështje kyçe që drejtojnë përformancën.

Analiza SëOT është një përmbledhje e imlikimeve kryesore të strategjisë të pazbuluara nga analiza e situatës.

implikimet strategjike të ndryshme klasifikohensi fuqi dhe dobësi, ose si shanse dhe kërcënime.

Pas analizës SëOT, çështjet më të rëndësishme duhet të identifikohen dhe të përshkruhen në mënyrë të plotë.

Mes implikimeve strategjike që përfshihen në analizën SëOT, ka çështje të rëndësishme që ndikojnë në performancë. Në këto çështje


Fuqitë
Dobësitë
SëOT
Mundësitë
Kërcënimet

- Duke përdorur një analizë të portofolit të tërheqjeve të tregut dhe avantazhet konkurruese, specifikohet një plan strategjik i tregut dhe objektivat e performancës.

- Qëllimi kryesor i një plani strategjik për tregun është sigurimi i një drejtimi strategjik nga ku të vendosen objektivat e performancës dhe udhëzimi për zhvillimi e një strategjie të marketingut taktik

- Plani strategjik është hapi më i rëndësishëm në procesin e planifikimit marketing, sepse kërkon një ekzaminim me kujdes të kërkesave të tregut dhe përparësive kokurruese të biznesit të bazuara në informacionin e siguruar nga analiza e situatës.

PROBLEMET KRYESORE:

Rritja e konsumatorëve të rinj, kërkon më tepër buxhet marketing deri në depërtimin e plotë në treg.

Fokusi i tregut, është i rëndësishëm pasi kemi kapacitet të kufizuar.

Furnizimi dhe çmimi, konkurrenca e reduktuar dhe furnizimi i shkurtër duhet të favorizojnë çmime më të larta.

- Në bazë të një plani marketing strategjik specific, zhvillohet një strategji e marketingut miks për të përmbushur objektivat e performancës së planit strategjik marketing.

- Zhvillimi i një strategjie marketing për të bërë efektiv planin strategjik të tregut.

- Strategjia e përgjithshme e marketingut për mbrojtjen, rritjen, reduktimin e përqëndrimit, për prodhimin, hyrjen apo daljen nga një pozicion i tregut është vendosur nga një plan strategjik i tregut, duhet të zhvillohen strategji taktike marketing më të specifikuara për çdo çështje thelbësore të performancës.

përkufizimit të një situate marketing.

Strategjitë marketing specifike të zhvilluara do të kenë po aq vlerë sa çështjet thelbësore të performancës.

STRATEGJiA E SEGMENTiT KRYESOR: PëRQëNDRiMi i REDUKTUAR.

1. Sugjerimi i vlerës

2. Strategjia e pozicionit

3. Sistemi i kanalit

4. Objektivat e fitimit.

- Një buxhet marketing për strategjinë marketing taktike duhet të zotërojë burime të mjaftueshme të shpërndara në mënyrë që të përmbushë objektivat e performnacës së planit marketing strategjik.

- Hartimi i një buxheti marketing është një hap kritik në ndërtimin e një plani marketing dhe shumë biznese nuk arrijnë të krijojnë një buxhet marketing adekuat.

- Procesi i hartimit të një plani marketing deri në këtë fazë nuk paraqet rrezik dhe pasoja ekonomike.

- Në këtë fazë përcaktohen burimet për çdo plan strategjik të tregut si dhe mbështetia e strategiisë së marketingut taktik me një buxhet

Shpërndarja e burimeve dhe buxheti marketing

- Mbi bazën e objektivave të pjesës së tregut për strategjinë e çdo segmenti si dhe të kostos respective të përvetësimit të konsumatorit të ri dhe mbajtjes së konsumatorëve ekzistues, hartohet një buxhet marketing për çdo segment tregu në një shtrirje kohore 5-vjeçare.

- Buxheti i marketingut për çdo segment është në përputhje me objektivin e pjesës së tregut për 5-vjeçarin e ardhshëm.

- Gjithashtu mund të përdoret dhe një strategji e përqëndrimit të reduktuar që kërkon një buxhet marketin më të vogël se segmenti alternative i kujdesit, më pak se 5 vjet.

HAPI VI: KOHËZGJATJA E PERFORMANCËS

- Një vlerësim i tregut dhe performancës së fitimit është bërë çdo vit për një planifikim marketing strategjik 3-5 vjeçar.

- Plani tregon për çdo segment sesi pjesa tregut, të ardhurat nga shitja, marzhet, shpenzimet marketing dhe rentabiliteti do të ndryshojë gjatë planifikimit 5-vjeçar.

- Kohëzgjatja e performancës paraqet një lidhje të ngushtë midis situatës, strategjisë dhe shpërndarjes së burimeve.

- Kohëzgjatja e performancës na jep një përshkrim të vlefshëm të saj, prej ku mund të vlerësohet performance aktuale, ndërkohë që

HAPI VII: VLERËSIMI I PERFORMANCËS

